SHABAN ÇUPI

TREVA E HANIT TË ELEZIT
1945-1975

Botim elektronik
në Internet archive

HANI I ELEZIT, 2025

Abstrakt

Gjatë kohës së Jugosllavisë së Titos, ndër vendet më të pazhvilluara të Kosovës, ishte treva e Hanit të Elezit, përkundër faktit se kjo trevë në gjirin e sajë kishte një aset të fuqishëm ekonomik siç ishte fabrika e çimentos me rezerva të mëdha të xehes së mërgeles. Menagjimi jo i mirë dhe mungesa e kuadrove si dhe analfabetizmi ekstrem që ekzistonte aso kohe në këtë trevë, ndikuan gjithanshmërisht në jetën e banorëve të kësaj treve. Me të dhënat që do t`i japim në trajtimin e kësaj periudhe 1945-1975, e cila llogaritet si një periudhë jo shum e ndriçuar, do të përpiqemi të sheshojmë shkaqet e ngecjes së kësaj popullate në të gjitha drejtimet e në anën tjetër edhe përpjekjet e forcave progresive për përparim e zhvillim shoqëror. Po në këtë punim, kemi trajtuar zhvillimet në arsim si dhe në fabrikën e çimentos si aset tepër i rëndësishëm për trevën e Hanit të Elezit dhe në fund kemi shkruar për suprimimin e komunave e në këtë rast edhe të komunës së Hanit të Elezit. Hulumtimin e kemi ilustruar edhe me

fotografi të ndryshme sa për të konkretizuar kohën.
Në ndriçimin e kësaj periudhe kemi shfrytëzuar burime të ndryshme elektronike dhe të shkruara si dhe faktorin njeri.
Fjalë kyçe:
Fabrikë, komunë, kuadro, shkollë, suprimim, zhvillim

Autori

Nga regjistrimet

Duke iu referuar regjistrimeve të para të popullsisë pas pushtimit serb, dhe regjistrimet e mëpastajme, dhe duke u mbështetur në të dhënat e Engjëll Gjinit[1], nga tabela e mëposhtme mësojmë se:

Fshatrat	Popullsija sipas vjetëve				Indeksi		
					1953	1961	1961
	1914	1948	1953	1961	1948	1948	1953
1. Dremjaku	98	156	184	148	117,9	94,9	80,4
2. Vërtomnica	65	200	62	42	31,0	21,0	67,7
3. Dimca	101	125	114	113	91,2	90,4	99,1
4. Pusteniku	474	615	628	519	102,1	84,4	86,6
5. Nëçavci	98	119	124	160	104,2	134,5	129,0
6. Palivodenica	200	182	330	330	181,3	181,3	100,0
7. Kriveniku	301	400	410	387	102,5	96,8	94,4
8. Goranca	299	539	583	567	108,2	105,2	97,3
9. Rezhanca	425	324	416	463	111,2	123,8	111,3
10. Seqishtja	283	457	502	548	109,8	119,9	109,2
11. Elez-Hani	—	154	369	764	239,6	470,1	196,2
Gjithësejt:	2347	3321	3722	4001			

Nga Tabela e regjistrimeve na bëhet e ditur se komuna e Hanit të Elezit në vitin 1948 kishte 3321 banorë, ndërsa në vitin 1961, kishte 4001 banorë. Pra, kemi të bëjmë me një komunë të vogël, por me një prapambeturi të madhe. Komuna e Hanit të Elezit si pjesë e Krahinës Autonome të Kosovës, shtrihet në një mikro-regjion të vogël, ku vendbanimet e kësaj ko-

[1] Engjëll Gjini „Fshatrat e rrethinës së Elez-Hanit'', revista Përparimi, 1968, Prishtinë

mune i ndanë lumi Lepenc, me Hanin e Elezit në fushëgropë, ndërsa vendbanimet tjera, djathtas dhe majtas lumit.

Fshati	Numri i shtëpive të shpërngulura			Numri i banorëve të shpërngulur		
	Shkup	Tetovë	Turqi	Shkup	Tetovë	Turqi
1. Dremjaku	9	—	2	90	—	17
2. Vërtomica	4	—	—	40	—	—
3. Dimca	8	—	—	60	—	—
4. Pusteniku	26	—	6	255	—	70
5. Nëçavci	10	—	—	35	—	—
6. Palivodeni	16	1	—	140	2	—
7. Kriveniku	10	6	—	90	50	—
8. Goranca	12	8	—	95	68	—
9. Rezhanca	11	8	—	100	60	—
10. Seqishtja	12	—	1	100	—	8
Gjithësejt	118	23	9	1005	180	95

Tabelë e të shpërngulërve në Shkup, Tetovë dhe Turqi[2]

Pas Luftës së Dytë Botërore (LDB-së), të pakënaqur me rrjedhat, shumë familje u shpërngulën në viset e tjera. Nga tabelari bëhet e ditur se janë shpërngulur 118 shtëpi vetëm në Shkup me 1005 banorë, 23 shtëpi në Tetovë me 180 banorë, në Turqi 9 shtëpi me 95 banorë. Në total i kemi 150 shtëpi me 1280 banorë. Duke pasur parasysh se treva e Hanit të Elezit është një regjion i vogël, ky numër i të

[2] Engjëll Gjini, Përparimi 1970, Prishtinë

shpërngulërve gjatë kësaj periudhe është i madhë.

Gjendja e trevës së Hanit të Elezit në fund të vitit 1944

Më 16 nëntor 1944, treva e Hanit të Elezit dhe e Kaçanikut u „çliruan" prej „armiqëve" dhe për 45 vite me radhë kjo datë do të kremtohet si ditë „çlirimi". Po në fakt si mbeti që 16 nëntori të shënohet ditë çlirimi në ish Jugosllavi? Ajo ditë është data kur u pre Bllaca shpi për shpi nga forcat partizano-çetnike duke marrur jetën e 111 kryefamiljarëve bllacjan. Lufta e rezistencës, zhvilluar në Karadak të Shkupit në vitin 1944, kundër depërtimit të forcave komuniste në Kosovë në krye me Avdyl Durën dhe humbja e kësaj rezistence, bënë që hakmarrja të bie mbi fshatin Bllacë, pasiqë Bllaca me Karadakun janë në kufij të njëri tjetrit. Pushkatimi i bllacjanëve edhe sot e kësaj dite ruhet thellë në memorien kombëtare të kësaj treve si një ngjarje e dhembëshme dhe tragjike.

Pas vendosjes së pushtetit komunist, në këtë trevë, fillon edhe mobilizimi ushtarak i të rinjëve për kinse ndjekjen e fashizmit në Jugosllavi. Kjo ndodhi edhe tek ne. Mobilizohen dhunshëm rinia e kësaj treve duke u dërguar viseve të ndryshme si në Srem, Tivar e Trogir, kinse në ndjekje të fashizmit gjerman, e në fakt shqiptarët vriteshin nga eprorët e tyre si ballist, nacionalist e reaksionar. Kjo ndodhi në Tivar, kjo ndodhi në Srem, kjo ndodhi edhe në Trogir, ku vetëm nga komuna e Kaçanikut në prill të vitit 1945 janë të vrarë 29 shqiptarë, 14 prej tyre nga Hani i Elezit dhe eshtrat e këtyre martirëve edhe sot e kësaj dite janë në Varrezat e Qytetit në Trogir të Kroacisë.

Tanimi dihet se këtë trevë gjatë historisë, krahas perandorive të mëdha, e kanë sunduar edhe ,,perandoritë'' tjera në fakt më të vogla, por të mëdhaja nga dhuna e terrori. Me 26 tetor 1912[3] kjo trevë pushtohet nga Serbia e Parë dhe kjo periudhë zgjati nga tetor 1912-

[3] Sipas Mr. Tefik Raka

1915. Nga 1915-1918 e sundojnë bullgarët e nga 1918-1941 mbretëria Serbo-Kroate-Sllovene, SKS pastaj blloku fashist italiano-bullgaro-gjerman dhe nga fundviti i vitit 1944 Jugosllavia socialiste e Titos.

Gjatë kohës së pushtimit bullgar, në Han të Elezit u vendos gurthemeli i objektit shkollor. Gurthemeli i kësaj shkolle u vendos në vitin 1943 dhe investitorë ishte fabrika e çimentos. Me gurë dhe me punë vullnetare u ndërtua kati i parë i objektit shkollorë. Objekti një katësh në fillim shfrytëzohej për mësim në gjuhën serbe dhe bullgare, sepse shqiptarët nuk kishin të drejtën e shkollimit në gjuhën amtare, ndërsa pjesa tjetër shfrytëzohej nga punëtorët e fabrikës për banim. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore (LDB) mësimi në këtë objekt nisi edhe në gjuhën shqipe dhe serbe, sigurisht me një numër të vogël nxënësish.[4]

[4] Historiku i shkollës fillore „Ilaz Thaçi'' e cila më parë quhej Tefik Çanga

Fillimi i vitit 1945, këtë trevë e gjeti të shkatërruar në shumë drejtime. Analfabetizmi dhe varfëria ishin „kryefjala" e kësaj treve, edhe pse kjo trevë statusin e komunës e kishte që nga viti 1913. Ka shumë rrëfime e përjetime që kjo popullatë ka përjetuar nga të tjerët. Në fshatin Gorancë ka qenë stacioni i xhandarmërisë serbe. Në stacionin e kësaj xhandarmërie janë torturuar shqiptarë derisa i ka lëshuar shpirti. Po këto tortura e mizerje ishin edhe gjatë pushtimit bullgar. Në vitin 1946 arrestohet ish kryetari i komunës së Hanit të Elezit, Islam Brava ku i mban 16 vite burg me akuzë se ishte kryetar komune në kohë të fashizmit gjerman dhe akuzohej për vrasjen e pesë serbëve të Shtërpcës te Dheu i Bardhë në Han të Elezit. Po në vitin 1946 arrestohet edhe kryetari i komunës Ali Huneli dhe pas gjashtë muaj hetime në Gjilan lirohet. Ishte i arrestuar me dyshime se ishte pjestarë i NDSH-së (Nacional Demokrat Shqiptar). Në vitin 1948 ishte vala tjetër e arrestimeve ku arrestohen Nazmi Brava, Rufat Brava, Halil Rogaqi e Shefket Thaçi dhe dënohen me burgje të

rënda. (Më gjerësisht shih librin Shaban Çupi ,,Jatakët e lirisë'') Në vitin 1956 në kohën e Rankoviqit, shkollat u bënë stacione të UDB-së dhe popullata e kësaj treve i mban mend mirë mizerjet e udbashëve, si të Perës së Muzeqinës dhe Qazim Metahusës së Gjakovës dhe ndihmësve të tyre rankoviqistë që i bënë mbi popullatën e kësaj ane, ashtu siç i mban mend mirë edhe mizoritë e serbëve milloshevigian në këtë trevë viteve të 90-ta të shekullit XX.

Nëpër këto rrëmuja të rënda, pas Luftës së Dytë Botërore, (LDB) po e rifillonte jetën e re, por me problem të vjetra edhe kjo trevë, duke u ballafaquar edhe me ,,otkupin'' pra për t`ia dhënë shtetit tepricën në kohën kur nuk kishin as kotheren e bukës. Krahas kësaj, në emër të emancipimit socialist, bëheshin trusni të ndryshme që binin ndesh me traditën, doket dhe zakonet e për pasojë shumë familje u shpërngulën në Shkup, Tetovë dhe Turqi. Shumë të tjerë mbetën me ,,visika'' në duar. Kështu ishte kjo ,,jeta e re''tanimë jo e kohës së krajlit, por tani nën tutelën jugosllave dhe nën sqetullën serbe.

Edhe në vendimet e Mbledhjes së Dytë të Avnojit që u mbajtë në Jajce më 29 nëntor 1943 për Kosovën nuk parashihej vetëvendosja si parim leninist i kombeve.[5] Këtë,,fat'' ia prenë Kosovës edhe në Kuvendin e Prizrenit në korrikun e vitit 1945, duke u shkelur vullneti i Konferencës së Bujanit për vetëvendosje, mbajtur me 31 dhjetor 1943, 1 e 2 janar 1944 në Bujan të Tropojës. Jugosllavia e Titos tanimë kishte gjashtë Republika: Republikën e Serbisë, Kroacisë, Sllovenisë, Bosnjes e Hercegovinës, Maqedonisë e Malit të Zi, kurse Kosova dhe Vojvodina mbetën krahina të Serbisë. Kjo ngrehinë jugosllave kishte 22 milion banorë dhe shqiptarët jo vetëm që mbetën jashtë trupit amë, por edhe më keq, brenda Jugosllavisë u ndanë dhe u rindanë edhe nëpër republika të tjera. Një pjesë mbeti në Kosovë, një pjesë në Maqedoni, Mal të Zi, e Luginë. Kjo ndarje e rindarje bëhej për të

[5] Më gjerësisht shih librin ,,Çështja kombtare-seri artikujsh, 1945

penguar homogjenizimin etnik të shqiptarëve dhe natyrisht për t`i shtypur më lehtë.
Fati i Kosovës dhe i viseve shqiptare, tanimë po thurej me „lesh'' djalli dhe duhej kërkuar rrugë të tjera për të arritur deri tek liria, deri tek çlirimi, deri tek mvehtësia. Kjo rrugë e gjatë, shqiptarëve në ish Jugosllavinë e Titos i kushtoi me 666 shekuj burg dhe me mijëra të tjerë të vrarë si dhe me shpërngulje masovike, ku vetëm në Turqinë e sotme kemi mbi 5 milion shqiptarë.

Fabrika e çimentos „Sharri'' në Han të Elezit

Treva e Hanit të Elezit, karakterizohet me sasi të mëdha të xehes së mërgelës e si rrjedhojë në vitin 1936 u ndërtua fabrika e çimentos. U ndërtua nga një shoqëri aksionare jo shqiptare që në kohë të „krajlit'' dhe që nga atëherë, banorët e kësaj treve u lidhën me fabrikën.
Konstruksioni i kësaj fabrike ishte i mbështetur në furrën e vetme vertikale, që kishte një

lartësi prej 12 metrash dhe një diametër prej 2.5 metrash. Punët e kryera kishin karakter manifaktural me bartjen direkte të mërgelës në furrë. Uzina në fjalë në vitin 1936, kishte një kapacitet prodhimi fizik prej 4.415 tonelata çimento në vit. Numri i të punësuarve ishte gjithësejt pesë punëtorë profesional dhe afro 150-160 punëtorë sezonal.[6]

Në vitin 1938 në fushëgropën e Hanit të Elezit evidentohen vetëm 16 familje të përhershme, të cilat këto familje kishin zbritur nga fshatrat, pasiqë kishin arritur të punësohen në fabrikë.[7] Popullimi më i madhë i Hanit të Elezit u bë në vitin 1968, pas hapjes së magjistrales dhe sipas Engjëll Gjinit në këtë lokalitet u vendosën rreth 100 familje nga Puset e Nikës, Rezhanca, Dërmjaku e Dimca.

Nga punët e rënda dhe pagat e vogla, në vitin 1938, punëtorët e kësaj fabrike shpallën edhe një grevë, por drejtori i fabrikës Boshko Zharaji i kërcënoi me largim nga puna dhe

[6] Gazeta informative ,,Sharri'' nr.63, nëntor 1986 faqe 2

[7] Revista ,,Përparimi'' nr.11-12, 1968

zëvendësimin e tyre me punëtorë serb nga Karadaku i Shkupit, rrëfente Ramadan Ballazhi.[8]

Kah mesi i vitit 1938, kur barra e rëndë e punës ishte bërë e padurueshme, punëtorët e kësaj fabrike provuan me grevë të luftonin për kushte më të mira. Kjo ishte e vetmja mënyrë që të shprehej pezmi… Tri katër ditë qëndruam nën hijen e një druri të madh që ishte në të hyrë të fabrikës… Vinin pronarët e na thonin që të kthehemi pranë makinave, por ne kërkonim rrogë më të madhe… Pas kësaj erdhi xhandarmëria me bajoneta në pushkë dhe me dhunë na futën në fabrikë… rrëfente Naim Daci.[9]

Kjo fabrikë kapacitetet e saja prodhuese vazhdimisht ka shkuar duke i rritur, por edhe defektet e makinave kanë qenë të shpeshta e për pasojë edhe remontet. Rreth punës së saj nëpër dekada ka të dhëna të mjaftueshme. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, shpëtoi nga

[8] Gazeta informative ,,Sharri'' nr.63, nëntor 1986 faqe 5

[9] Rilindja 24 shkurt 1978

bombardimi, por nuk arriti t`u shpëtoj problemeve të brendëshme.
Ngritja e fabrikës fillon që në vitin 1933, kurse në vitin 1936 fillon prodhimin. Fabrika punonte me mjete primitive. Mërgelja bartej me qerre. Gjithashtu edhe drujtë për furrë. Fillimisht, rrymën e siguronin nga miniera e Radushës, ndërsa më vonë nga qyteti i Shkupit. Kjo fabrikë ka funsionuar edhe gjatë LDB-së dhe ka qenë në shërbim të gjermanëve dhe bullgarëve. Në majin e vitit 1947, kjo fabrikë kishte vetëm 40 punëtorë dhe 4 furra primitive[10] Deri në vitin 1949 kjo fabrikë selinë e ka pasur në Shkup. Në vitin 1946 prodhoi 24 mijë tonë çimento. Në vitin 1952 formohet Këshilli i Punëtorëve si formë vetëqeverisëse. Pas LDB-së nevojat për çimentë ishin të mëdhaja. Rritet edhe numri i punëtorëve. Tani kjo fabrikë kishte rreth 400 punëtorë dhe bashkëpunonte me Dalmacia cementin e Splitit. Krahas kësaj, në vitet në vijim, fabrika ana-

[10] Rilindja 14.11.1986

lizat laboratorike të çimentos i bënte në laboratorin e Rijekës në Kroaci.

Në periodën 1948-1952, dhe në vitet në vazhdim, është ndërtuar kolonia e punëtorëve. Banesat janë ndërtuar për nevojat e nënpunësve të inkuadruar në fabrikën e çimentos. Ndërtesat e banimit dhe godinat e fabrikës, vendit ia ndërruan pamjen.[11] Një ndërtesë e tillë e ndërtuar për kuadro dhe stafin menagjues të fabrikës është edhe ndërtesa e sotme e godinës së komunës. Banesat ndërtoheshin, siç cekëm më lartë për kuadrot e ,,importuara'' të fabrikës, dhe për synimet tjera kolonizuese, ndërsa ndërtesa afër shkollës së sotme të mesme ,,Dardania'' ishte ndërtesë për oficerët e armatës jugosllave dhe familjeve të tyre. Kazermat e ushtrisë serbe ishin ndërtuar që në kohën e ,,krajlit'' para vitit 1939. Këto kazerma kishin edhe sistemin e rezervuareve të kerozinës për aeroplanët

[11] Hani i Elezit vështrim regjional gjeografik, revista Përparimi nr.11-12, 1968, Prishtinë

dhe thënë më së shkurti, treva e Hanit të Elezit jetonte mbi eksploziv.

Njëri nga bunkerët e kerozinës

Puna në fabrikë ishte e rëndë dhe bëhej me mjete primitive. Deri te porta e sotme e fabrikës, pas LDB-së dhe vite më pas, kanë qenë të ndërtuara binaret, mbi të cilat vendoseshin vagonët të mbushur me mërgele.Vagonët tërhiqeshin me anën e kuajve

dhe lënda përfundonte në fabrikë e më pastaj shndërrohej në çimentë.
Punëtorët e kësaj fabrike ishin nga fshatrat për rreth. Udhëtimi i tyre bëhej në këmbë verë e dimër. Migracioni ditor i fuqisë punëtore i të inkuadruarëve në fabrikën e çimentos, është relativisht i madhë. Çdo ditë prej fshatrave zdirgjen në Han të Elezit. Pjesa më e madhe zbresin dhe kthehen në këmbë, duke kaluar 4-14 km. në ditë.[12]
Edhepse plani i rikonstruktimit të kësaj fabrike ishte paraparë që në vitin 1953, punët nuk rrodhën si u planifikuan. Ajo planifikonte të prodhojë 150 mijë tonelata çimento në vit, por s`mund t`i arrinte as 100 mijshin. I tërë stafi menagjues ishte joshqiptarë dhe sabotimet e heshtura ishin evidente. Ja një rast. Menagjmenti i fabrikës e blejnë një mulli në Belgjikë i cili duhet të prodhonte 18 tonelata çimentë. Ai jo vetëm që nuk i arrinte tonelatat e synuara, por prishjet e shpeshta që i ndodhnin, ndikonin negativisht në të gjitha seg-

[12] Gazeta Rilindja 14.11.1986, Prishtinë

mentet. Propaganda se kualiteti i çimentos së Hanit të Elezit ishte i dobët, mbuloi tregun e në anën tjetër fabrika e çimentos ,,Usje'' në Shkup pushtoi tregjet. Në luftën e tregjeve, humbësi tanimë dihej.

Se si ,,zihej'' puna brenda kësaj fabrike më së miri e pasqyron një shkrim në gazetën Rilindja i datës 8 maj 1958, ku ndër të tjera me mjaft guxim thuhet se askund nuk mund të ndihem më shumë se sa këtu mungesa e ekspertave, në vend të pesë ingjinierëve këtu punon vetëm një, mungojnë 25 punëtorë me kualifikime të larta, në vend të tyre punojnë njerëzit e pakualifikuar. Shfrytëzimi i padrejtë nga ana e drejtorit të mjeteve shoqërore, uzurpimi i organeve qeverisëse, udhëtimet e shpenzueshme, borgjet, stoqet e krijuara dhe të gjitha këto kanë krijuar paknaqësinë tek punëtorët.

Në një kronikë tjetër, po nga Rilindja e datës 12 janar 1958, thuhet se kjo fabrikë nuk ka realizuar planin e paraparë. Plani i prodhimit është realizuar 85%, i klinkerit 94, kurse i shitjes 77% dhe përshkak të shitjes së dobët të

çimentos, shpesh kanë ndalë prodhimin. Që çimentoja të jetë më kualitative është paraparë të marrin gurë kuarci në fshatin Dimcë i cili sipas tyre është në sasira të mëdhaja.
Një karakteristikë tjetër, po nga kjo kronikë është se çimentoja e kësaj fabrike jo vetëm që është brenda konkurencës së asaj të Shkupit dhe Serbisë, por produkti i kësaj fabrike shumë pak shitej në Kosovë, ndërsa krahina (Kosova) çimenton e merr nga Dalmacia. Ajo që s`mund ta thotë gazetari në kronikën e tij është se kreu i fabrikës ishte jo shqiptar dhe si i tillë dhe në mënyrë të heshtur kjo fabrikë mbahej vetëm gjallë. Remontet e shpeshta, shkaktonin ndërprerjen e prodhimit, pastaj paknaqësinë e punëtorëve në paga, mungesa e kuzhinës për ushqim, humbja e guximit për të protestuar, jo vetëm që fabrikën e mbanin të gjallë vetëm sa për të thënë, por sinonim i fabrikës ishte edhe vetë jeta e banorëve të kësaj treve, sepse ishin fort të lidhur me fabrikën. Ajo ishte shpresa dhe varri i kësaj treve. Shpresa qëndronte tek mbijetesa dhe zhvillimi, ndërsa varr ishte bërë ambienti i

ndotur, tmerrësisht i ndotur, duke lënë pasoja të mëdha në organet respiratore dhe jovetëm.
Nga një kronikë e asaj kohe thuhet se 15% e prodhimtarisë së përgjithshme të çimentos fluturon në ajr e për pasojë jo vetëm që fabrika ka humbje, por edhe punëtorët rrezikojnë shëndetin e tyre, e në anën tjetër është dëmtuar edhe ambient në shkallë të gjërë.
Në janar të vitit 1959 u hap restoranti për ushqim të punëtorëve të fabrikës. Kronika thotë se në kuadër të këtij restoranti tani për tani ushqehen 40 punëtorë dhe nënpunësa të fabrikës dhe çmimi është i volitshëm. Restorantin e punëtorëve e ka hapur Kooperativa bujqësore.[13] Në majin e vitit 1959 stafetën e Titos nata e zuri në Han të Elezit dhe „gjumin" e sajë e bëri në fabrikë. Të nesrmen ajo iu dorëzua Republikës së Maqedonisë.

[13] Rilindja, janar 1959

Pamje nga shkolla fillore në fshatin Paldenicë, 1956

Model i ri shtëpie në fshatin Gorancë, shtëpi e ndërtuar në vitin 1958

Çka shkruan Rashit Gashi në kujtimet e tij për gjendjen në arsim në vitin 1956/57 dhe çka Rexhep Krusha?

Fillimisht kam punuar në fshatin Paldenicë të Hanit të Elezit, shkruan Rashit Gashi nga Orllati i Drenasit. Më vonë edhe në qendër si drejtor shkolle. Atyre viteve u njoha drejtpërsëdrejti me rrethanat shoqërore dhe ekonomike të kësaj popullate. Madje u inkuadrova aq shpejtë sikur të isha pjesë përbërëse vite me radhë e kësaj popullate, prandaj edhe punova me tërë qenien time. Vendi ishte i pazhvilluar në çdo pikëpamje. Popullata ishte e varfër. Skamje e madhe, gati ekstreme, por njerzë të mirë e shumë bujarë, të ndershëm e të respektuar, mikëpritës e punëtorë. Edhe pse pushtuesit e huaj, të herë pas hershëm kishin lënë gjurmë me ndikimet e tyre, ata përpiqeshin që t`i mbanin e kultivonin traditat e të parëve. Për ata edhe pushteti aktual nuk ishte më i mirë se pushtetet e kaluara. Shpresa e vetme e kësaj treve ishte fabrika e çimentos ,,Sharr' ku punonin pjesa dërmuese e punëtorëve të kësaj treve si punëtorë krahu dhe në punë të rënda

e të vështira, sepse punët më të lehta e më të mira i kishin zënë ardhacakët dhe të huajt, nga të gjitha trevat e Jugosllavisë, madje edhe shoferët e të gjitha kategorive. Në këto rrethana unë e ndjeja vetin mjaft keq, jo vetëm si mësues, arsimtar e drejtor shkolle, por edhe si njeri sepse asnjë kuadër arsimorë në këtë shkollë, me të gjitha paralelet fizike të ndara (tetë sosh) nuk i kishte vendas. Ne, tani i nxjerrnim kuadrot e para, me shkollë të plotë tetëvjeçare. Në këto kushte e rrethana fillova t`i qesë në letër disa përshtypje të mia, kujton Rashit Gashi në librin e tij.[14]

Drejtori aktual i shkollës fillore „Ilaz Thaçi'' në Han të Elezit, Akif Shkreta, vite më parë me këta dy mësues e ish drejtor shkolle, realizoi një bashkëbisedë më të zgjeruar të cilat po i shpalosim në vazhdim:

Rexhep Krusha është i lindur në Mitrovicë në vitin 1935 e me preardhje nga Krusha e Rahovecit kishte përfunduar Shkollën Normale në Prishtinë dhe i kualifikuar si mësues për

[14] Rashit Gashi ,, Rrugët e shtegtimit'' Prishtinë, 2012

ciklin e ultë. Edhe pse në moshë të shtyer e me harresë evidente, mësuesi Rexhë rrëfen me nostalgji se kishte punuar në Han të Elezit që në moshën 17 vjeçare, duke cituar një thënie ,,çka piqet nuk hiqet'' që nënkuptohet sipas tij që ende i ka të freskëta disa kujtime për Hanin e Elezit. Ai tregon se ishte drejtor i shkollës, ku klasët ishin katërklasëshe dhe njëkohësisht përmendë se ishte ndër mësuesit e parë të kualifikuar të asaj kohe. Ai tregon se kur ka qenë drejtor shkolle, Hani Elezit ishte komunë në vete. Në kujtesën e tij mbante mend disa prej nxënësve të tij duke kërkuar ndjesë për të tjerët që nuk i mban mend. Nxënësit e tij të parë ishin Adem Shkreta, Shukri Vila, Ajet Vila, Bedrije Vila, Shyrete Topojani e shumë të tjerë. Në fillim të shkollës ishin 45 deri 50 nxënës.

Bashkëbisedimin e dytë, rrëfen Akif Shkreta, e kisha me drejtorin e dytë të shkollës, Rashit Gashin i lindur në vitin 1933 në Orllat të Drenasit. Ishte i kualifikuar ndër brezat e parë në Shkollën Normale. Sipas tij, pos si mësues, ka punuar edhe si drejtor shkolle rreth tri vite.

Kujtimet për këtë trevë dhe si ishte gjendja në arsim, mësuesi Rashit Gashi i ka të botuara në librin ,, Rrugët e shtegtimit'' e që ne i shkruam më lartë, ndërsa për Akif Shkretën gjatë bashkëbisedimit, mësuesi Rashit ndanë edhe këtë rrëfim: Meqenëse koha ishte e ndjeshme dhe delikate e me plotë rreziqe, kërkohej maturi për çdo veprim. Hani i Elezit ishte frymëzim që të merrem edhe me shkrime letrare, kryesisht me poezi, por të mbështjellura nën petkun e metaforës dhe alegorisë, për të fshehur ndjenjën e vërtetë… isha nën vëzhgim të shërbimeve. Nga kujtesa e tij mësojmë se nxënës të tij që i kujtohen ishin Adem Shkreta, Ismail Bushi e Kadri Kuka.

Drejtorët e parë të Shkollës Fillore në Han të Elezit: Rexhep Krusha, Rashit Gashi e Sabri Hoxha nga periudha 1956-1961[15]

Gjendja e përgjithshme ekonomike e banorëve të komunës së Hanit të Elezit

Banorët e trevës së Hanit të Elezit janë marrur kryesisht me bujqësi e blegtori. Fondi i lopëve, dhenëve dhe dhive nuk ka qenë i vogël. Pozita relievore e trevës e mundësonte një gjë të tillë. Por, më vonë u ndalua mbajtja e dhive si brejtës të malit. Krahas kësaj, banorët e trevës së Hanit të Elezit janë marrë edhe me shitjen e

[15] Historiku i SHFMU,,Ilaz Thaçi'' Hani i Elezit

drujve në Shkup. Bartja e drujve është bërë me qerre të cilën e tërhiqnin qejtë. Shitja e drujve është bërë edhe me kuajë e gomarë dhe largësia nga Hani i Elezit deri në Shkup ishte 22 km. Krahas drujve, janë shitur edhe pemë të ndryshme e në veçanti Dardhat Turke dhe arrat. Lëvrimi i arave bëhej me mjete primitive me parmendë e shumë më vonë me pllug. Mungesa e uji jo të mjaftueshëm, ndikonte që edhe rendimentet e drithërave të ishin të vogla. Në atë kohë Jugosllavia importoi nga Italia farë më cilësore gruri e njëkohësisht edhe projektin e merinizimit të deleve. Ishin të rralla shtëpitë që siguronin bukën e motmotit, andaj punësimin në fabrikë e llogarisnin si shpëtim ekonomik. Krahas fabrikës, një pjesë jo e vogël e banorëve të Gorancës, Rezhancës e Krivenikut kanë punuar në minierën e Radushës dhe puna në minierë ishte shumë e rëndë. Në shumë shtëpi ende si relikte ruhen karabitët e minierës të cilët përdoreshin për dritë. Ditë tregu në Han të Elezit nuk kishte. Tregu mbahej ditën e premte në Kaçanik, ndërsa të martën në Shkup. Në të shumtën e

rasteve kjo trevë, tregun e ka zhvilluar në Shkup dhe kjo ka zgjatur deri vonë.
Pas LDB-së, pushteti i ri komunist organizoi kurse për zhdukjen e analfabetizmit dhe kjo ishte një e mirë që vlerësohej. Të gjithë ata që sado pak dinin shkrim-lexim morën rolin e mësuesit. U zhvilluan edhe kurse shëndetësore për mbajtjen e higjenës trupore dhe shtëpiake si dhe kurse të amvisërisë. Sëmundjes ngjitëse si tuberkulozi, zgjebja, tifoja, fruthi dhe shumë të tjera ishin prezente. Ky edukim shëndetësor dhe arsimor vlerësohej nga popullata, por jo nga të gjithë. Shkollimi i femrës ishte tepër i vështirë. Pushteti popullor siç quhej në atë kohë, mori masa me të drejtë edhe ndëshkuese që të shkolloheshin vajzat. Filloi aksioni i madh për heqjen e çarçafit dhe perçës te gjinia femërore dhe ky aksion zgjati disa vite.[16] Në mungesë të objekteve shkollore, mësimi ka filluar në objektet e xhamive dhe mejtepeve në kushte të rënda. Mungonte jo vetëm libri, por edhe mjetet më themelore të

[16] Burimi: Elham Kalisi, 2020

mësimit si lapsi e fletorja. Fillimisht, nxënësit paiseshin me një lloj dërrase të vogël e cila luante rolin e dërrasës së zezë dhe quhej papirus dhe mbi këtë dërrasë, shkruhej me një lloj shkumësi që quhej tebeshir. Dërrasa kryente funksionin e fletores dhe njëkohësisht të librit sepse nuk kishte as libër e as fletore. Dërrasën nxënësi e merrte me veti në shtëpi për ushtrime detyrash.[17] Megjithate, dëshira për të ecur përpara ekzistonte, tjetër gjë ishin kushtet dhe tjetër gjë ishin mundësitë.

Në luftë kundër malarjes

Në një kronikë tjetër të 21 gusht 1955, tregohet për problemet shëndetësore të popullatës së Kaçanikut dhe Hanit të Elezit me sëmundjen e malarjes, ku thuhet se gjatë muajve korrik dhe gusht janë evidentuar rreth 100 raste me sëmundjen e malaries. Kronika shpjegon edhe ndërhyrjen e Pleqësisë për shëndetin popullor

[17] Burimi: Sefer Çupi(1945-2022), informatë dhënë autorit në vitin 2014

dhe politikë sociale të rrethit të Ferizajt dhe bashkë me Institutin higjenik të Krahinës organizuan një luftë kundër malarjes duke i spërkatur shtëpitë, shtallat dhe objektet tjera përcjellëse. Krahas kësaj mësojmë se stacioni shëndetësor në Kaçanik dhe Han të Elezit janë paisur me barna të nevojshme kundër malarjes. Nga kronika kuptojmë se në Han të Elezit ka ekzistuar stacioni shëndetësor, por me mjek maqedon. Raste të tilla thotë kronika, kjo trevë ka pasur edhe në vitin 1946, ndërsa si shkak i përhapjes së malarjet thuhet të ketë qenë mbjellja e orizit në luginën e Lepencit. Në vitin 1959[18], në Kaçanik hapet dhoma e rentgenit, aq i nevojshëm për kohën, sepse tuberkulozi kishte një shtrirje jo të vogël. Para se të hapej shërbimi rentgenologjik, banorët e kësaj treve shërbimet i kryenin në Ferizaj ose në Shkup.

[18] Rilindja, 19 gusht 1959

Fabrika e çimentos ndotës i madh i ambientit

Po si ishte gjendja kadrovike e trevës së Hanit të Elezit në vitin 1956?

Duke iu referuar shkrimit në gazetën Rilindja të datës 20 dhjetor 1956, mësojmë se: Komuna e Hanit të Elezit ka 11 vendbanime dhe 6 mijë banorë. Shkolla fillore kishte 12 arsimtarë të gjithë të pakualifikur, në përjashtim të një serbi, ndërsa drejtor shkolle ishte Rexhep Krusha. Është me rëndësi për të cekur se nga 12 mësuesit e asaj kohe, asnjëri nuk ishte nga

treva e Hanit të Elezit. Ky raport i shprehur në formë kronike, tregon se treva e Hanit të Elezit ishte në një gjendje shumë të rëndë arsimore.
Në anën tjetër e njejta gjendje ishte në Këshillin Popullor të Komunës, ku pos kryetari dhe një nënpunës që ishin nga kjo trevë, të tjerët ishin „jabangjinjë"
E njejta gjendje e rëndë ishte edhe në fabrikën e çimentos ku vetëm punëtorët ishin shqiptarë dhe nuk kishte asnjë nënpunës vendas.
Gazetari Shemsi Mehmeti në kronikën në vazhdim jep edhe një detaj tjetër me rëndësi ku thotë se ,,Pas çlirimit, nëpër vende të ndryshme janë hapur shkolla tetëvjeçare, mirëpo në Jankoviq[19] (Lexo në Han të Elezit)

[19] Nga vitit 1913, Hanin e Elezit, pushtuesi serb zyrtarisht e ka emërtuar Gjeneral Jankoviq. Gjeneral Bozhidar Jankoviqi ishte Komandant i Armatës së Tretë serbe të Nishit, i cili në tetor të vitit 1912, forcat e tij vranë 15 kryefamiljarë të fshatit Dërmjak. Terror të tillë, këto forca bënë në tërë Kosovën. Në shenjë triumfi,,vllada'' serbe, Hanin e Elezit të sotshëm e emërtoi dhunshëm me emrin Gjeneral Jankoviq dhe zyrtarisht nuk njihej emër tjetër. Kjo ka zgjatur deri në vitin 2012, kur Kuvendi komunal i Hanit të Elezit e hoqi këtë emër të urryer. Kjo vonesë zyrtare ndodhi pasiqë UNMIK-u nuk lejonte

edhe pse qendër më e madhe se disa vende të tjera, këtu ende nuk ka shkollë të plotë tetëvjeçare, andaj këtu nuk ka asnjë nxënës që ka kryer shkollën fillore dhe nëse eventualisht dikush e ka kryer tetëvjçaren, ai e ka kryer në ndonjë komunë tjetër"

Në kronikën tejet të rëndësishme të gazetarit të lartëcekur, jepet edhe një e dhënë tjetër nga fabrika e çimentos e cila sipas dispozitave ligjore të asaj kohe, duhet t`i aftësoj 15 kuadro ekonomike, por ajo merr vetëm fuqi punëtore të moshës madhore, kurse Këshilli Popullor i komunës i jep vetëm katër bursa edhe atë tre mësuesve dhe një nxënësi të shkollës së mesme medicinale, por që asnjëri nuk janë nga treva e Hanit të Elezit.

Duke e parë këtë gjendje tepër të rëndë kadrovike, kronisti jep alarmin që këtë trevë

---

ndryshime të tilla! Zyrtarisht tanimë kjo komunë quhet Hani i Elezit, ndërsa në gjuhën serbe Elez-Han. Hani i Elezit, në zhargonin popullorë, ndryshe është quajtur edhe Draçe. Emri Draçe rrjedh nga vllahishtja që don të thotë kryqëzim rrugësh, nyje ku ndërlidhen edhe rrugët e tjera, udhëkryq.

duhet ta ndihmojmë të ngritet në këmbë duke intervenuar edhe organet e larta krahinore.
Deputeti që mbulonte edhe trevën e Hanit të Elezit ishte Aleksa Vuçiniçi, në fakt Aleksa ishte një udbash i Rankoviqit i cili në vitin 1948 zhvilloi hetimet ndaj grupit të arrestuar të Nazmi Bravës me shokë, ku njëri nga ata mbeti i kastruar për tërë jetën.
Marrë në tërësi, në të gjitha fushat kishte forca që synonin të zhvillonin këtë trevë si në fushën ekonomike edhe ate arsimore, por kishte edhe forca të tjera regresive dhe sabotuese ndaj këtij zhvillimi dhe që i kushtonin me prapambetje të thellë kësaj treve.

Hapja e tetëvjeçares së plotë në shtatorin e vitit 1957

Shkollat katërvjeçare, si në Han të Elezit, Paldenicë, Puset e Nikës, Gorancë, Rezhancë, Kryenik, Laç, Dërmjak e Seçishtë kishin vite që funksiononin, por Hani i Elezit nuk kishte shkollë të plotë tetëvjeçare. Nxënësit që krye-nin katërvjeçaren nuk kishin mundësi që të

vazhdonin shkollimin. Mungesa e një shkolle tetëvjeçare shkaktonte problem të mëdha në arsimimin e gjenaratave të reja, andaj ngritja e një shkolle të tillë ishte bërë domosdoshmëri.
Në këtë drejtim, shtatori i vitit 1957 shënon një të arritur të madhe në fushën e arsimit. Në Han të Elezit u hap shkolla e plotë tetëvjeçare. Paraprakisht u ndërtua kati i dytë i shkollës në Han të Elezit me tetë dhoma mësimi e krahas dhomave u ndërtuan edhe gjashtë banesa për arsimtarë dhe familjet e tyre. Në vitin paraprak kishte vetëm një mësues të kualifikuar, ndërsa në vitin 1957, nga gjashtë arsimtarë të kualifikuar, tre ishin shqiptarë. Nxënësit që u regjistruan në tetëvjeçaren e sapohapur, shkollën e plotë fillore do ta përfundojnë në majin e vitit 1961 dhe numri i tyre përbëhej prej 16 nxënësish.[20] Shkollat mbanin emra të ndryshëm, por më 16 nëntor 1961, shkolla fillore në Han të Elezit u emërtua me emrin e antifashistit shkodran Tefik Çanga, kurse shkollat

[20] Burimi: Halim Ballazhi, nxënës i kësaj gjenerate

nëpër fshatra mbetën paralele fizike të shkollës amë.

Nga një dokument arkivor[21], gjatë vitit shkollor 1961/62, arsimtarët që punonin në trevën e Hanit të Elezit ishin:

Në Han të Elezit: Bajram Haskaj, Ali Saraçini, Gjyljeta Saraçini, Haxhi Hasaj, Ruzhdi Kastrati, Zef Lleshi, Adelajde Lleshi. Në fshatin Seçishtë punonte, Raif Zejnullahu dhe Yzeir Husiqi. Në Puset e Nikës, Shaban Begolli. Në fshatin Laç, Hajzer Behrami. Në fshatin Paldenicë, Halit Thaçi. Në fshatin Dërmjak, Shyqeri Ramadani. Në Gorancë, Metë Hamzaj, Jakup Hoxha, Sylejman Ismajli. Në Krivenik, Ajet Thaçi. Në Rezhancë, Sadri Hasaj.

Me hapjen e kësaj shkolle dhe rritja e numrit të arsimtarëve të kualifikur, shënohet një ngritje e nivelit arsimor, por megjithate larg, tepër larg nevojave që i kërkonte koha.

[21] Historiku i SHFMU,, Ilaz Thaçi'' Hani i Elezit

Si e pasqyron gjendjen në arsim mësuesi Bajram Haskaj në një shkrim të tij në gazetën Rilindja të janarit 1959?

Shumë Këshilla Popullor të komunave nuk kanë kuadro profesionale, por këshilli popullor i Hanit të Elezit se merr seriozisht problemin e arsimit në komunë. Ai thotë se brenda një viti shkollor janë ndërruar tetë referenta të arsimit. Ky ndërrim i shpeshtë i referentëve, pa asnjë arsyetim publik, ka rënë në kurriz të shkollave, mësimit dhe vetë arsimtarëve, duke lëshuar alarmin se shkollat e kësaj komune gjenden në situatë të mjerueshme, pa mjete konkretizimi, mësuesit nuk kanë vendime pune si dhe shtesat e rrogave nuk janë marrë.

Fabrika e çimentos „Sharri'' në Han të Elezit fillon të rimëkëmbet

Pas një gjendje të rëndë nëpër vite që pësonte kjo fabrikë, me angazhimin edhe të organeve krahinore, në tetorin e vitit 1959 kjo fabrikë filloi rimëkëmbjen. Kjo rimëkëmbje bënte lajmin sepse kishte vite që punonte me hum-

bje, ndërsa punëtorët morën pagën e plotë të tyre.
Në një shkrim të gazetarit Jusuf Kelmendi të datës 4 tetor 1959 thuhet se veprimtarinë e fabrikës vite me radhë e përcolli një mori të metash të cilat e vunë në pikëpyetje ekzistencën e kësaj organizate ekonomike. Bilanset ishin negative, kualiteti i prodhimit i dobët… Punëtorët merrnin 80% të pagës… Por me angazhimin e Këshillit Popullor Krahinor dhe pas masave kadrovike që ndërmori, ato dhanë efektin e tyre dhe për tetë muaj punë në vitin 1959, është prodhuar më shumë se sa tërë vitin e kaluar. Drejtori aktual i fabrikës ishte Skender Namlixhiu[22] dhe nga kujtimet e më të vjetërve, na bëhet e ditur se ishte nga Gjakova dhe ishte organizues i punës. Merita e veçantë e tij është se e shpëtoi fabrikën nga falimentimi ku po e fundosnin elemente të caktuara.
Pra, brenda këtyre viteve, ndër të tjera janë dy të arritura që vlerësohen. Në shtator të vitit 1957 edhepse me shumë vonesë, fillon punën

[22] Rilindja, 4 tetor 1959

shkolla e plotë tetëvjeçare, ndërsa në aspektin ekonomik, viti 1959 shënon kthesën e parë për të ecur përpara.
Krahas këtyre të arriturave, në kuadër të fabrikës ishte planifikuar që në vitin 1960, të hapet Universiteti i Punëtorëve, ku nëpërmjet kurseve do të bëhet aftësimi profesional i punëtorëve si dhe shkolla përgatitëse ekonomike. Shkolla e Mesme Ekonomike u hap në vitin 1962 dhe vepronte në kuadër të fabrikës dhe ishte një shkollë me shumë rëndësi, sepse prodhonte kuadro për nevoja të fabrikës. Katër orë mësonin lëndët teorike në objektin e shkollës fillore në Han të Elezit, kurse katër orët tjera mësonin praktikën në fabrikë dhe pas tri viteve, merrnin diplomën e shkollimit të mesëm. Ata që synonin të vazhdonin shkollimin, i parashtroheshin provimeve në Shkollën Ekonomike të Prizrenit dhë në Obiliq, Fushë Kosovë.

Kush ishin kryetarët e komunës së Hanit të Elezit nga 1913 e deri në suprimimin e saj

Kryetarët e komunës para Luftës së Dytë Botërore ishin: Fejzë Bushi, Osman Vila, Behxhet Bushi dhe Gani Kaloshi. Gjatë kohës së LDB-së ishte Islam Brava. Pas LDB-së ishin, Ali Huneli, Hasan Shkreta, Halil Bushi, Merxhan Laçi dhe Ferat Laçi, ndërsa punët e ofiqarisë i kryente Ramiz Bushi meqë dinte shkrim-lexim.[23]

Përveç tjerave, mungonte edhe rryma

Krahas shumë gjërave të tjera elementare, në trevën e Hanit të Elezit pas LDB-së dhe deri vonë, nuk kishte as rrymë. Llamba vajgurore ishte burim drite, kurse fabrika e çimentos ishte shpresa. Meqenëse fabrika fillimisht mori rrymën nga Radusha, qyteza e Hanit të Elezit dhe fshati Seçishtë u elektrifikuan nga kjo rrymë nëpërmjet fabrikës. Seçishta u elektrifikua në vitin 1952, gjithashtu edhe fshati Gorancë në vitin 1952 po nga Radusha. Në vitin 1958, fabrika rrymën e mori nga

[23] Emrush Dernjani, Hani i Elezit me rrethinë, Prishtinë 2001, faqe 38

Shkupi. Filloi edhe elektrifikimi i vendbanimeve të tjera, por edhe pagesa e rrymës bëhej në Shkup. Në vitin 1958 u elektrifikua fshati Dimcë. Fshati Dërmjak u elektrifikua me mjete vetanake dhe rrymën e mori nga fshati Dimcë. Në vitin 1962 u elektrifikua fshati Paldenicë. Fshati Laç në vitin 1973, Puset e Nikës në vitin 1980, ndërsa Kriveniku në vitin 1981. Nga këto të dhëna, mësojmë se me sa vështirësi depërtoi drita këtyre anëve. Edhe pse u elektrifikuan këto vendbanime, në një kronikë të Rilindjes së shkurtit të vitit 1963 thuhet se shpenzimet e rrymës të banorëve konsumues i paguan fabrika. Kur në një vend mungon kaq gjatë energjia elektrike, merret me mend se sa e rëndë ishte jeta e banorëve të kësaj treve.
Trevën e Hanit të Elezit, lumi Lepenc e ndante në dy pjesë. Në anën e djathtë gravitonin fshatrat: Seçishtë, Krivenik, Puset e Nikës, Laç, Rezhancë dhe Gorancë, kurse në anën e majtë fshati Dimcë, Dërmjak, Paldenicë, Neçavc dhe Vërtomicë. Lidhja e këtyre dy anëve me Hanin e Elezit bëheshin me anën e urave. E para urë

ishte ajo e Fejzës, të cilën në vitin 1920 e ngriti ish kryetari i komunës Fejzë Bushi dhe të gjitha fshatrat e shfrytëzonin këtë urë. Ura tjetër është ajo e fshatit Laç e cila ishte e ndërtuar nga druri, kurse nga betoni u ndërtua në vitin 1970. Fshati Seçishtë, pos që lidhej me Urën e Fejzës, ndërtoi edhe një urë lëvizëse me sajllë. Po në këtë formë lidheshin edhe Puset e Nikës, por shirat e rrëmbyeshëm, bënin që të ngritej edhe niveli i lumit Lepenc dhe këto ura si pasjë, shpesh kanë pësuar nga përmbytjet.

Ura e Fejzë Bushit e ndërtuar në vitin 1920, fotografi e Kryqit të Kuq amerikan

Ura e Bushëve-Puset e Nikës

Asfaltim nuk kishte askund. Aksi rrugor Shkup –Hani Elezit-Prishtinë ishte shtruar me zhavor, ndërsa për mjet të udhëtarëve shfrytëzohej treni. Hekurudha si arterje komunikacioni ka funksionuar që nga viti 1874. Banorët e kësaj treve më së shumti udhëtonin për në Shkup. Arsyeja e parë ishte se me Shkupin e lidhte farefisi, tregu i Bit Pazarit dhe shumë punëtorë të kësaj ane që si fuqi punëtore, punonin në Shkup. Për herë të parë asfalti kësaj ane vjen kur u shtrua

magjistralja Shkup - Prishtinë e cila u bë në vitin 1968 e cila ndryshe quhej Magjistralja e Adriatikut.
Në vitin 1968 ende nuk kishte as pompë të benzinës. Banorët me karburante, furnizo-heshin në Shkup ose në Ferizaj, por ç`ishte e vërteta, shumë të rralla ishin edhe makinat.

Makina zyrtare e fabrikës

Mënyra e jetesës dhe mjetet e punës

Gjatë kësaj periudhe 1945-1975, krah i vetëm pune ishte fuqia puntore. Lëvrimi i arave

bëhej me parmendë e cila tërhiqej nga qejtë. Meqenëse punohej me mjete primitive, edhe rendimentet e drithërave ishin të dobëta.

Në trevën e Hanit të Elezit, nga drithërat kultivohej: gruri, elbi, thekra, jarica, meli, tërshëra e misri. Mbillej edhe orovi për kafshë si dhe pekmezi i cili ndryshe quhej edhe „kallamoq pekmezi'' sepse rritej i gjatë mbi dy metra, por jo më i trashë se gishti i dorës. Nga kjo bimë nxirrej lëngu i tij dhe pastaj zihej. Me këtë lëng lyhej buka. Në fshatin Seçishtë është mbjellur edhe orizi.

Drithërat korreshin me drapërinjë dhe ara mbushej dorëza-dorëza që në trevën e Hanit të Elezit quheshin „pollogja''. Me ndihmën e liktyrave lidhej duaji. Liktyra prodhohej nga kashta e thekrës, pasiqë thekra rritej e gjatë. Shirja e drithërave bëhej në lamë e cila para se të shtroheshin duajt, lyhej me bajga të kafshëve. Pasi lyhej lama me bajga, në atë mënyrë qëndronte disa ditë që të terej. Pas kësaj, rreth mullarit vendoseshin duajtë dhe më pas fillonte fshirja e lamës. Ajo zakonisht bëhej me kuaj të cilët silleshin e rrotulloheshin

në lamë pothuajse gjatë tërë ditës, derisa kokrra e grurit ndahen nga kalliri. Kur kokrra e grurit ndahej nga kashta, kashta futej në mashën për ushqim bagëtishë, ndërsa gruri grumbullohej në lamë dhe hidhej me tërplotë duke e ndarë kokrrrën e grurit nga byku dhe pas këtij procesi ndarës, gruri i ngarkuar në thasë të dhijtë dërgohej në mulli dhe bëhej miell. Shirja e grurit në lamë, në trevën e Hanit të Elezit është bërë deri në vitin 1982.
Lufta për kokrrën e grurit ishte luftë për jetën. Shumë familje nuk mundnin ta siguronin atë. Edhe më e rëndë bëhej kur tokat i mbulonte thatësira. Rendimentet bienin, kështuqë krijohej kriza e bukës. Në trevën e Hanit të Elezit njihej kriza e bukës për dy vite me radhë në kohën e Bugarit të Dytë, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kishte raste kur gruri fshihej në pitosa nëntokësorë se ta merrte ,,hiqimeti''. Kjo ka ndodhur edhe pas përfundimit të luftës sidomos në kohën e ,,otkupit'' jugosllav, kurë nga shqiptarët kërkohej që të dorëzonin tepricën, ndërsa në fakt ata nuk e siguronin as të domosdoshmen.

Bluarja e drithërave bëhej në mulli dhe kjo trevë shquhet me mullijtë e shumtë si në lumin Lepenc e sidomos në rekën e Laçëve, Dimcës dhe të Dërmjakut. Argatia ishte një formë tjetër e punimit të bujqësisë dhe ishin të shpeshta rastet kur i zoti i shtëpisë thërriste fqinjët e tij në ndihmë për lëvrimin e arës dhe në prashitjen e misrit, ndërsa gratë ftonin fqinjet e tyre në korrje të grurit dhe elbit. Argatia në këtë trevë ka qenë e theksuar dhe është zbatuar deri në fund të viteve 80-ta të shekullit XX.

Ndryshimi i mjeteve të punës, ndryshoi edhe formën e punës. Traktori dhe makina korrëse dhe shirëse transformuan jetën, por edhe kjo teknologji pune në këtë trevë është shumë e vonshme. Sa për ilustrim në fshatin Paldenicë, për herë të parë erdhi makina që fshinte duajtë në vitin 1983. Kombaji shumë më vonë, ndërsa në Gorancë e Krivenik disa mjete pune janë përdorur më herët.

Formë e lëvrimit të arës me anë të parmendës, fotografi e vitit 1969

Korrja e grurit me drapër, Seçishtë 1978

Në periudhën që po trajtojmë veku ishte një mjet tjetër i jetesës. Veku ishte ,,fabrika'' e veshjes. Me anë të vekut thureshin: janat, çilimat, tirqit, xhurdijat, këmishat, mitanët, brezat, pëlhurat, çarçafët, skutaqet, veshjet e nusërisë dhe çka jo tjetër. Lëndë të parë kishin leshin e deleve i cili lnorej në Shkup, pasiqë në këtë trevë nuk kishte makina lnorëse. Disa nga veshjet, ngjyrën e merrnin nga gjethet e arrave si dhe nga gjethet e Japrakut që me shumicë gjendej në Kep të Hisarit. Me ndihmën e gjetheve, ngjyroseshin tirqit, mitanët e xhurdijat. Nuk mungonte as kultivimi mëndafshit i cili përdorej për qendisje të pajës së nuserisë dhe prodhohej nga krimbi i mëndafshit.

Që të prodhohej mëndafshi duhej mbështetur në dy faktorë kryesor: klimës së vendit dhe drurit të Manit të Bardhë. Pasi merrnin krimbat i mbështjellnin me gjethe të Manit të Bardhë dhe njëkohësisht i ofronin kushte nxehtësie. Brenda këtyre kushteve, krimbat shumoheshin dhe formonin gëzhollen e rreth saj, krijoheshin fijet e mëndafshit.

Se mëndafshi është prodhuar në trevën tone, krahas Xhezide Çupit (1925-2006) e pohon edhe Nezakere Dernjani nga fshati Paldenicë[24] e martuar në Shkup, por edhe drugdhendësi Jakup Kaloshi (1941) nga fshati Guranë[25], i cili dëshmon se kur kam qenë fëmijë rreth 10-12 vjeç kam parë plakat e katundit duke prodhuar mëndafshin nga krimbat. Ai thotë se krimbi ushqehet me gjethet e manit dhe grumbulli i krimbave mbështjellen me gjethe mani të cilët pastaj formojnë gëzhollen e rreth saj fijet e mëndafshit.

Në vend të shamponit përdorej Humza e cila merrej tek Dheu i Bardhë, ndërsa për larjen e petkave shfrytëzohej Fini.

Humëza është dhe, përkatësisht lloj dheu, afërsisht i përngjanë kitit dhe pasi nxjerrej nga toka, formonin toptha të vegjël dhe pastaj është përdorur për pastrimin e flokëve, në formë shamponi. Në shumicën e rasteve,

[24] Informatë nga Nesim Dernjani dhënë autorit Shaban Çupi më 18.9.2013, Paldenicë, Hani i Elezit

[25] Informatë e Jakup Kaloshit (1941) dhënë autorit Shaban Çupi më 18.9.2013, Hani i Elezit

Humëza është përzier me një sasi të vogël vajguri dhe kjo përzierje ka ndihmuar në shkrehjen e flokëve të vajzave, të cilat i kanë pasur të gjata deri në bel. Humëzën e gjenin në vende të ndryshme, por më së shumti, në Han të Elezit, te Dheu i Bardhë.

Krahas Humëzës, për pastrimin e rrobeve, është përdorur Fini. Pasi vlonin ujin në kazan, merrnin hirin nga oxhaku dhe e hedhnin në ujin e valë në kazan dhe pas qëndrimit për një kohë të caktuar, ujin e vluar me hi e kanë qitur mbi rrobe, sidomos mbi pëlhura dhe kështu e bënin pastrimin. (Më gjerësisht shih librin *Gjurmime etnografike* nga autori Shaban Çupi.)

Enët e metalta rikuperoheshin nga kallajgjijtë, ndërsa shekat, tërplotet, sofrat dhe mjetet tjera të punës ndërtoheshin nga lënda drurore. Gjithashtu pjatat ishin nga druri dhe alumini, lugët gjithashtu nga druri, ndërsa vorbat nga dheu. Për tundjen e kosit përdorej ftini, ndërsa në vend të këpucëve, barteshin opingat të cilat prodhoheshin nga lëkura e kafshëve.

Kultivoheshin pemët dhe perimet, por nuk mungonte as hardhia e rrushit si dhe bima

industriale, duhani i cili pasi thahej, grihej në havan.

Katundi gurra e ngjarjeve

Jeta e banorëve të kësaj treve, historikisht ka qenë jo e lehtë. Dimrat ishin të rëndë e stina e verës e thatë. Toka ishte jo aq pjellore dhe punohej me parmend e pllug dhe të gjitha këto ndikonin që edhe bereqetet të mos jenë edhe aq të mira.

Katundi si vendbanim, ishte epiqendra dhe gurra e ngjarjeve. Ishte një bashkësi ekonomike e shoqërore dhe kishte territorin e tij. Katundin, si gurrë e ngjarjeve, e përbënin familjet e mëhallët që kishin një harmoni mes veti dhe solidaritetin ndaj njëri-tjetrit e shfaqnin në formën e argatisë. Brenda katundit frymonte jeta, ruheshin adetet, zakonet, lojërat, këngët e vallet. Gëzoheshin kur pas natës së gjatë dilte drita, ndërsa shqetësoheshin kur mbi kulm të shtëpisë këndonte qyqja. Numri i pikave të zeza në Lulemarre ishte masë matëse e turpit në shoqëri dhe shqetësoheshin kur pikat e

zeza pakësoheshin. Qitnin pushkë gëzimi kur lindte një fëmijë, ndërsa vajohej e grrithej fytyra kur vdiste ndokush.
Katundi si vendbanim më i hershëm, ruante dhe kultivonte rregullat e jetës. Kishte të parin e tij apo kryeplakun dhe tentohej që jeta të zhvillohej në mënyrën autoktone, kështuqë edhe binin ndesh me ligje e zakone të push-tuesve.
Familjet ishin të mëdha dhe me shumë kurora. Organizimi i mënyrës së jetesës bëhej nga i zoti i shtëpisë dhe pavarësisht se sa e rëndë ishte jeta, familja e madhe si numër, ngër-thente në vetvete sigurinë dhe fuqinë. Në rrethana fatkeqësish, fjala e familjeve të më-dha kishte rolin e tyre vendimarrës. Në trevën e Hanit të Elezit, jeta organizohej sipas rregu-llit të fisit, mëhallës e katundit, por nuk mba-het mend që të jenë organizuar edhe sistemi i bajraqeve. Fiset më të theksuar në këtë trevë janë: fisi Thaç, pastaj Berishë e Krasniqe. Këtë mënyrë organizimi të jetës, sado patriarkale që ishte, pushtuesit vazhdimisht janë munduar ta zhdukin e bashkë me atë, janë përpjekur të

tjetërsojnë edhe zakonet, traditat, këngët, vallet dhe veshjen tonë. Gjithmonë, nën vellon e shkatërrimit të së vjetrës, synohej të zhdukeshin gjurmët iliro-shqiptare. (Më gjerësisht shih librin *Panoramë e trashëgimisë kulturore në trëvën e Hanit të Elezit* nga i njejti autorë.)

Shtëpitë

Katundet, zakonisht ngriteshin rreth maleve e në sukore të kodrave që të ruhej toka e bukës, ndërsa shtëpitë ishin kryesisht dykatëshe dhe të ndërtuara me gurë, ndërsa dritaret ishin të vogla dhe me grila. Që të ndërtohej një shtëpi, duhej që me muaj të tërë të barteshin gurët dhe trajtë të cilët ishin nga bungu e qarri. Puna ishte aq e rëndë sa që thuhej se: "Kur ndërtohet shtëpia, ose qetë ngordhin ose i zoti i shtëpisë sëmurej". Pasi në themele prehej një kurban për mbarësi, fillonte ngritja e shtëpisë. Radhiteshin gurët njëri pas tjetrit dhe lidheshin me baltë e cila përzihej me byk. Gushakët e drurit ishin pjesa tjetër lidhëse e murit dhe kur përfundonte kati i parë, vendoseshin trajtë të cilët lidheshin me

gozhda e kllëfa hekuri. Pllafoni shtrohej me dërrasa bungu dhe njëkohësisht mbulohej me baltë. Oxhaku i shtëpisë fillonte që nga kati përdhesës dhe vazhdonte ndërtimi i tij edhe në katin e dytë. Në katin përdhesës ishte dhoma e shtëpisë me oxhak, ku qëndronin gratë dhe kishte raste kur ishte ftohtë, ndahej përgjysmë me bagëtinë, përkatësisht lopët të cilat ishin pasuria e familjes. Në katin e parë ishte edhe dhoma e çarranikut ku mbaheshin bulmetërat si dhe „izba”për mjete pune. Kati i dytë i saj kishte odën e mysafirëve dhe dhomat e tjera përcjellëse të vëllezërve, të gjitha këto të shtruara me jana e çilima, jastëk kashte e dyshek prej leshi, cerga, postaqia e hastra. Kur shtëpisë i ngritej kulmi,ishte ditë gëzimi. Familja e farefisi, për mjeshtrit që ndërtonin shtëpinë, sjellnin „bakshishë” zakonisht peshqirë, këmisha dhe gjëra tjera. Pas kësaj, kulmi mbulohej me qeremide e kulumarë. Ndarja e dhomave është bërë me gurë e çerpiçë, ndërsa lyheshin me baltë e byk e në fund, fjalën e kishte gëlqerja. Varësisht nga besueshmëria e mjeshtërit që ndërtonte

shtëpinë, në kuadër të murit ndërtohej një „bunker" për mbajtjen e një martine dhe në ballë vendosej guri që maskonte atë.
Oborri rrethohej me avli, murë guri i cili pos derës së madhe në hymje, kishte edhe derën e kapigjikut. Për ato familje që ishin më të varfëra, oborrin e rrethonin me huj e thupra të shkozës. Personi që kishte më shumë bagëti në oborr kishte edhe ahurin e kafshëve, por gjithsesi në oborr të shtëpisë ishte edhe hambari i misrit, i drithit, lugjet e bagëtive dhe koritat për ujë. Në oborr ishte bunari për ujë të pijes i cili murosej me gurë, mbi të cilin ngritej një kulm i vogël për t`u mbrojtur nga shirat, ndërsa në fund të tij vendoseshin dy dërrasa bungu të kryqëzuara.
Shtëpitë që ndërtoheshin në trevën e Hanit të Elezit, ishin nga guri, të tipit kulla të vogla dhe shoqëroheshin edhe me çardak. Në të shumtën e rasteve, nevojtoren dhe hamamgjikun e kishin në kuadër të shtëpisë, në pjesën e jashtme të murit. Dera e shtëpisë natën mbyllej me shul, ndërsa për roje të

shtëpisë shërbenin qentë. Më gjerësisht *Gjurmime etnografike* nga i njejti autorë.
Dasma ishte gëzim i madh familjar dhe i tërë katundit. Në trevën e Hanit të Elezit, dasmat fillonin ditën e mërkurë, ndërsa të enjten merrej nusja, pra „xhumambrama'' dhe vazhdonte edhe disa ditë tjera dhe ishte një ritual i veçantë gazmorë. Pasiqë ndahej vadja e dasmës, katundarët solidarizoheshin me të zotin e dasmës duke sjellë nga një teneqe grurë tek i zoti i shtëpisë, pastaj gruri mblidhej dhe dërgohej në mulli dhe shndërrohej në miell. Kjo bëhej që të mos dëmtohej i zoti i dasmës, pasiqë rendimentet e grurit nuk ishin të larta. Kështu veprohej edhe me sigurimin e drujve, pothuajse secili fqinjë sjellte nga një kalë dru. Drujtë shërbenin për gatimin e gjellërave. Për burra caktoheshin gjellbërësit të cilët quheshin„ jakqi''. Ata zienin edhe havllën e dasmës. Në anën tjetër, për gatimin e bukës caktoheshin magjatoret, ndërsa për shërbim në dhoma të dasmorëve, shërbenin hizmeçarët. Secila dhomë kishte nga dy „hizmeqarë''. Detyra e tyre ishte veshja e dhomës me

jana, çilima, jastakë e sende të tjera përcjellëse. Hizmeçarët bënin edhe shtrimin e sofrave për ngrënje. Shërbyesit e dhomës kishin për detyrë që të jenë prezentë në dhomën e dasmorëve deri në fund të dasmës. Në të kundërtën „koritnin" të zotin e dasmës. Ishte një punë me shumë përgjegjësi. Dasma bëhej me lodra, por nuk mungonin as këngëtarët. Në një rast, viteve të 50-ta në Paldenicë, erdhën rapsodët e njohur Hashim Shala e Tahir Drenica dhe me këngët e tyre rapsodike, mbetën gjatë në kujtesën popullore.



Hashim Shala e Tahir Drenica, 1960

Fetah Buçi e Muharrem Dardhishta, rapsod të cilët viteve të 70-ta, merrnin pjesë në dasmat e kësaj treve

Pas marrjes së nuses e cila në të shumtën e rasteve merrej me kerr të kuajve. Fillimishtë kerri mbulohej me çilima. Pos grave të kerrit, në kerr merrej edhe djali i kerrit që simbolizonte pjellshmërinë, natalitetin. Në raste kur nusja merrej nga fshatra të thella, ajo merrej me kalë me shalë. Mbulohej nga koka deri tek këmbët me një lloj thesi të tejdukshëm. Kali tërhiqej nga një person dhe kishte për detyrë që nusja të mos rrëzohej nga kali. Në trevën tonë ishte një ritual karakteristikë i zbritjes së nuses.

Në momentin kur nusja hipur mbi kalë futej në derë të oborrit, dhëndrri nga pjata që mbante në duarë shpërndante në drejtim të nuses grurë, leblebija e sheqera. Pastaj kali me nusen mbi shpinë duhej që ta kalonte një zgjedhë. Me ritualin e zgjedhës simbolizohej harmonia ndërmjet burrit dhe gruas në jetën martesore. Kuptimi tjetër i ritualit zgjedhor, ishte tejkalimin e gjitha pengesave jetësore, duke përfshirë edhe sihrin, përkatësishtë magjinë. Pas këtij rituali, nusen nga kali e zbriste vjehrri, babai i dhëndërrit.

Nusja e sapozbritur, djalit të kerrit i vendoste një plis të bardhë në kokë i cili simbolizonte lindjen e fëmijëve fillimisht mashkull. Krahas këngëve që vajzat këndonin për nusen, ajo drejtohej në drejtim të dhomës së sajë. Edhe në derë të dhomës nusja duhej që të prekte pjesën e sipërme të derës në shenjë bereqeti. Pas këtij rituali në dhomë të nuses futej dhëndrri i cili në të shumtën e rasteve për herë të parë shihte nusen e tij. Në anën tjetër, burrat organizonin lojra tradicionale, si: vrapim të kuajve, vrapim të burrave, kërcim në tre hapa si dhe hedhjen

e gurit. Këto lojëra priteshin me gëzim dhe ishin garuese. Në fund çdo fitues, shpërblehej nga paja e qeizit të nuses.
Në pika shumë fragmentare, kjo ishte mënyra e jetesës gjatë periudhës që po trajtojmë. Kështu ishin zakonet, doket dhe adetet të cilat edhe sot ruhen në këtë trevë.

Suprimimi i komunës së Hanit të Elezit

Pavarësisht pushtimeve, treva e Hanit të Elezit, statusin e komunës e kishte që nga viti 1913 dhe i takonte rrethit të Nerodimes. Objekti komunal ka qenë në afërsi të QKMF-së së sotme. Objekti u ndërtua viteve të 30-ta të shekullit XX. Megjithate luante rol pozitiv sepse shërbimet e nevojshme, banorët e kësaj treve i kryenin pa pasur nevojë të shkojnë në vende të tjera. Pushteti i ri socialist jugosllav synonte reforma në shumë fusha të jetës. Një reformim të tillë e parashihte edhe në rior-

ganizmin e komunave dhe të territoreve të tyre.
Gjatë kësaj kohe, në të gjitha nivlet jugosllave po diskutohej forma e re e veprimit të komunave dhe rretheve. Kërkohej të shkarkoheshin nga komunat e tepërta, pra kërkohej centralizimi i tyre. Diskutimet e tilla u bënë gjatë vitit 1957 e 1958. Një diskutim të tillë e bëri edhe Fadil Hoxha, kryetar i Këshillit Ekzekutiv të krahinës së Kosovës në tetor 1959 ku tha se do të suprimohen rrethet e të formohen komunat e forta. Për rrethin e Ferizajit janë paraparë tri komuna: ajo e Ferizajt, Kaçanikut dhe e Shtërpcës.
Më 13 nëntor 1959, Këshilli Ekzekutiv i Serbisë aprovoi projektligjin mbi suprimimin e rretheve të Krahinës Autonome të Kosovës dhe projektligjin mbi teritoret e komunave dhe rretheve. Kosovës iu caktuan t`i ketë 28 komuna dhe nga 1 kallnori (janari) 1960 të gjitha komunat e reja do të funksionojnë në bazë të këtij projektligji[26].

[26] Rilindja, 14.11.1959

Ashtu siç edhe pritej nga vendimet e suprimimit të komunës së Hanit të Elezit dhe shkrirjen e sajë në komunën e Kaçanikut, kjo ndodhi më 19 dhjetor 1959. Në mbledhjen konstituive të Këshillit Popullor të Kaçanikut, që u mbajt në Kaçanik e ku merrte pjesë edhe Nënkryetari i Këshillit Ekzekutiv të Krahinës, Zhivojin Qurçiç dhe në prani të dy ish komunave u formua komuna e re. Kryetar i komunës së re të Kaçanikut me Hanin e Elezit brenda u zgjodh Hilmi Vardari, ndërsa nënkryetar u zgjodh Sali Bajra. Pos zgjedhjes së kryetarit dhe të nënkryetarit, Këshilli zgjodhi edhe pleqësitë dhe komisionet tjera përcjellëse. Me këtë vendim, shuhet edhe komuna e Hanit të Elezit, status të cilin e kishte nga viti 1913. Tanimë kjo ish komunë merr statusin e Bashkësisë Lokale dhe kishte veprimtari të kufizuar. Pos certifikatës së lindjes dhe asaj të kurorizimit, nevojat e tjera banorët e kësaj ane i kryenin në Kaçanik.

Nga 1 janari 1960 e deri më 22 shtator 2005, treva e Hanit të Elezit do të gravitoj në kuadër të komunës së Kaçanikut. Me përfundimin e

luftës së vitit 1998/1999 dhe me Kosovën e çliruar u krijuan rrethana krejtësisht të tjera. Me 22 shtator 2005, në procesin e decentralizmit të Republikës së Kosovës të cilën e udhëhiqte Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, MAPL, Hanit të Elezit i njihet statusi i Pilotnjësisë komunale dhe në korrikun e vitit 2008, merr kompetencat e plota komunale.

Me çka karakterizohet periudha 1960 - 1975

Komuna e Kaçanikut si komunë e centralizuar, tanimë me Hanin e Elezit brenda saj, bënte përpjekje të ecte në hap me kohën, por buxheti i vogël komunal nuk mundësonte një zhvillim të dëshirueshëm. Në këtë vit, komuna ndau shumë bursa për nxënës, sepse nevoja për kuadro ishte e madhe. Kishte filluar elektrifikimi, por ai ecte me hapa shumë të ngadalshëm. Në vitin 1960 u bën përpjekje që të hapet shkolla në fshatin Dërmjak, pasiqë

nxënësit e këtij fshati udhëtonin në fshatin Paldenicë. Gjatë këtij viti u mbajtën edhe zgjedhjet për Dhomën e komunave dhe ate të prodhuesve ku përfaqësuesit e Hanit të Elezit jepnin kontributin e tyre në Kaçanik. Po në këtë vit u bë edhe fuzionimi i Koperativës së Hanit të Elezit në ate të Kaçanikut.

Kamionët me të cilët bartej çimentoja për në treg, fotografi e vitit 1960

Viti 1960 shënon edhe një karakteristikë tjetër, fabrika e çimentos ngriti kapacitetet prodhuese, punëtorët morën pagën e plotë, defektet ishin më të rralla dhe vullneti për të ecur përpara ishte i madhë. Që në vitin 1957,

pranë fabrikës u formua Shoqëria *Miqtë e natyrës*, e cila përbëhej nga nënpunës dhe punëtorë të fabrikës. Kjo Shoqëri në vitin 1960 realizoi disa ekskurzione në vende të ndryshme në Jugosllavi e sidomos në fabrika të çimentos për shkëmbim përvojash. Krahas kësaj brenda fabrikës u themelua Universiteti i punëtorëve, ku punëtorët përgatiteshin për dhënien e provimeve në Shkollën Ekonomike të Prizrenit. Në anën tjetër, Shkolla fillore tetëklasëshe në Han të Elezit, në prillin e vitit 1962 kishte këtë gjendje:

Shkolla amë në Han të Elezit kishte 300 nxënës dhe 11 paralele ku punonin 12 arsimtarë. Në paralelet fizike nëpër fshatra kishte 13 arsimtarë dhe shumë nxënës. Derisa në shkollën amë arsimtarët janë të kualifikuar, në fshatra, nga 13 sosh vetëm njëri është i kualifikuar dhe krahasuar me vitet e tjera, gjendja në arsim megjithate është më e mirë. Shkolla amë është furnizuar me diaskop dhe filma mësimor, magnetofon me shirita, radioaparat e gjësende të tjera. Meqenëse klasa e VI ende nuk është hapur në fshatin Gorancë, nxënësit e

këtij fshati detyrohen të mësojnë në Han të Elezit. Ende është shqetësuese vijimi i vajzave. Edhe pse të regjistruara janë 60 vajza, ato nuk vijojnë mësimin. Nga viti 1954, pranë kësaj shkolle ka funksionuar edhe shkolla për të rritur dhe ka përcjellur tri gjenarata me 100 nxënës.[27]

Nga Koperativa bujqësore, te Uji i Thartë u ngrit byfeja si pikë qëndrimi për vendas e turist që kalonin këtyre anëve. Në dhjetorin e vitit 1960, për herë të parë fabrika e çimentos realizoi planin e paraparë prej 100 mijë tonelatash çimento. Stacioni shëndetësor në Han të Elezit siguron makinën e ndihmës së shpejtë, ndërsa paraprakisht fabrika e çimentos e ndihmon stacionin shëndetësorë me një makinë të tipit ,,Shkoda''. Mbetej problem në vazhdimësi ndotja e ambientit. Përkundër ndërhyrjeve të vogla, ky problem mbeti i pazgjidhur. Bashkë me tymin lirohej edhe një pjesë e çimentos duke shkaktuar edhe humbje. Jo vetëm që shkatërrohej flora e fauna, por

[27] Rilindja, 3prill 1962

njerëzit kishin problem edhe me diarrenë. Në Kaçanik tanimë ekzistonte Sanatoriumi ose pushimorja për fëmijë me shëndet të dobët me 100 shtretër. Sanatoriumin e ka themeluar Kryqi i Kuq i Kosovës, por më vonë në mbikqyerje e merr spitali i Prishtinës. Këtu shëroheshin njerëzit me tuberkuloz dhe sëmundje tjera respiratore, pasiqë ky vend njihet edhe si vend i dy klimave, është kufi klimatik.

Sanatoriumi në Kaçanik i vitit 1958 dhe një pamje e Kaçanikut e vitit 1965[28]

[28] Burimi: Rilindja

Në vitin 1960, në Han të Elezit, u ndërtuan dhjetë banesa montazhë e krahas këtyre edhe dy ndërtesa me tetë dhoma banimi. Në majin e vitit 1961, ndodhin vërshimet e mëdhaja të shoqëruara me erë. U dëmtuan urat dhe shumë pjesë të Hanit të Elezit. U dëmtua edhe hekurudha. Për një muaj ditë fabrika e çimentos nuk mundi të kryej shërbimet e saja me Shkupin, ndërsa në fshatin Seçishtë u dëmtuan shtyllat e rrymës.[29]

Gjatë vitit 1961, ndodhi edhe epidemia e verdhzës e cila goditi fëmijët e fshatit Go-

[29] Burimi: Rilindja

rancë e Pustenik si dhe në Glloboshicë, Ivajë e Kotlinë. Pacientët u dërguan në spitalin e Shkupit dhe ate të Tetovës.[30] Meqenëse situata ishte shqetësuese, Këshilli Popullorë i Komunës kërkoi edhe ndihmën e organeve shëndetësore krahinore.

Në stacionin shëndetësor, aty ku sot është Shtëpia e Kulturës, viteve të 50-ta e 60-ta mjekët ishin kryesisht serbo-maqedon. I vetmi teknik medicinal ishte Musli Jusufi i cili ,,zanatin'' e mjekut e kishte marrur gjatë shërbimit ushtarak.

Në vitin 1961, për herë të parë, në klubin e punëtorëve u vendos televizori. Kjo ishte një mundësi e mirë që punëtorët të shpërndanin lajmet në familjet e tyre dhe në rrethin ku jetonin. Radio rrallë kush që mund të kishte. Këto ishin të vetmet mjete që banorët e kësaj treve mund të lidheshin me botën.

Në një kronikë të Rilindjes së marsit 1963, thuhet se në Shkollën Ekonomike të fabrikës, mësimet i ndjekin 43 nxënës të profileve të

[30] Rilindja, tetor 1961

ndryshme si në degën mekanike, elektrike dhe automekanike, por shqetësues është fakti se 35% e punëtorëve të punësuar janë krejtësiht analfabetë që nuk dinë shkrim-lexim. Kronika vazhdon se pas bashkimit të fabrikës së çimentos ,,Sharr'' me atë të gëlqeres,,Lepenci'' në Kaçanik, numri i punëtorëve është rritur.

Kur në korrikun e vitit 1963 ndodhi tërmeti i fuqishëm në Shkup, popullata e kësaj ane jo vetëm që u solidarizua me popullatën në Maqedoni, por ofroi ndihma për aq mundësi që kishte për farefisin e tyre në Shkup, kurse fabrika e çimentos mori pjesë në ndërtimin e objekteve të rrënuara nga tërmeti. Krahas kësaj në një raport të komunës së Kaçanikut thuhet se pas tërmetit janë evakuar shumë familje nga Shkupi e pastaj edhe nga Dibra.

Gjatë këtyre viteve u hap edhe salla e kinemasë ku shfaqeshin filma të ndryshëm. Në këtë sallë kinemaje, nxënësit e kësaj treve kanë parë filmat e parë shqiptar me vlerë kombëtare, si: *Skënderbeu, Tungujt e luftës, Komisarin e dritës dhe Debatikun.*

Në vitin 1966, kjo trevë u përballë me vërshime të mëdha. Reka e Dimcës u rritë aqë shumë saqë rrezikoi edhe fabrikën. [31] Vërshimet dhe përmbytjet, siç thotë Engjëll Gjini, ishte edhe shkaku që kjo fushgropë nuk kishte vendbanim të më hershëm.

Më 1 e 2 korrik 1966, në Brione të Kroacisë, u mbajt Plenumi Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, dhe në atë plenum, Titoja shkarkoi Aleksandër Rankoviqin për abuzime të mëdha me pushtetin, më saktë me shqiptarët. Rankoviqi me pretekst të kërkimit të armëve, nëpërmjet UDB-së, gjymtoi në shkallë të gjërë qenie shqiptare e për pasojë shumë njerzë vdiqën në tortura, shumë të tjerë mbetën të gjymtë tërë jetën e shumë të tjerë nga reprezaljet e vitit 1956 u shpërngulën edhe në Turqi. Ky ishte vetëm një segment shoven, por problemet ishin edhe më të thella. Rryma unitariste serbe synonte t`ia dridhte karrikën edhe vetë Titos, por këtë gjë Titoja e

[31] Përparimi nr.11-12, 1968

hetoi dhe nuk mund ta lejonte, andaj edhe e shkarkoi.
Shkarkimi i Rankoviqit, ku siç thuhej zyrtarisht, vijës së tij deformuese, në Kosovë ndikoi në të gjitha sferat. Forcat progresive në Kosovë, shfrytëzuan këtë rast për zhvillim të mëtejmë. Këto zhvillime pozitive do të kenë ndikimin e tyre edhe në trevën e Hanit të Elezit, sidomos në emrimin e drejtorëve shqiptar.
Në vitin 1966, Sali Bajra (1934-2006) drejtor financiarë me juristin Xhemal Krasniqin, në fabrikën e çimentos në Han të Elezit, përpiluan rregulloren e re të sistematizimit të vendeve të punës. Me këtë rast shumë serbë e malazezë analfabet që punonin në administratën e fabrikës mbetën pa punë[32]. Në fakt, synimi i politikës rankoviqiste ishte që çdo pore të jetës ta mbushte me kolon serb, në këtë rast kolon industrial. Pas largimit të tyre, këto vende pune, zëvendësohen me kuadro

[32] Ramadan Asllani,, Sali Bajra-kushtrimi i kohës'' Ferizaj 2016, faqe 83

shqiptare që u kualifikuan në ndërkohë dhe treva e Hanit të Elezit, këto veprime të Sali Bajrës i ka vlerësuar me kohë.
Gjithashtu, Sali Bajra me shokë iu kundërvunë përpjekjeve të disa funksionarëve krahinorë serbë, që fabrika e çimentos të bartej nga Hani i Elezit në Leposaviq.[33] Pra, kjo fabrikë si një vend ku vendasit kishin shpresa për zhvillim, ajo që nga fillimi ishte sabotuar në forma të ndryshme, ndërsa tani synohej të bartej krejtësisht në Leposaviq.
Në vitin 1967 në Kaçanik, nën politikën kombëtare të Sali Bajrës, hapet shkolla për punëtorë të kualifikuar e cila në atë kohë u emërtua me emrin „Voskopoja'' e që për politikën jugosllave ishte provokative. Krahas kësaj u hap edhe gjimnazi të cilin e pagëzuan me emrin e Skënderbeut. Për ngritjen e kuadrove të reja, Sali Bajra si kryetar komune, lëshoi shumë bursa për nxënës, me një fjalë kudo që shkelte e vepronte tribuni Sali Bajra, mbillej fara e lirisë dhe e përparimit.

---

[33] Po aty faqe 84

Në vitin 1967, në Han të Elezit, u hap Duqani Madh i cili furnizonte banorët me artikuj të ndryshëm ushqimorë. Lokacioni i tij ishte në afërsi të objektit ku sot është Enti Social. Para se të hapej Duqani i Madh, ky lokacion ishte kafe e Muharrem Bravës, ndërsa në prapa-shpinën e tij, ëmbëltoren e ka pasur Lamia i Gjakovës. Para se të hapej Duqani i madh, shitore ka pasur Halit Kriveniku dhe lokacioni i tij ka qenë në afërsi të QKMF-së së sotme.[34] Posta ka qenë aty ku sot është këndi i lojërave përballë komunës, ndërsa ambulanta, siç cekëm edhe më lartë, ka qenë aty ku sot është Shtëpia e Kulturës.

Në vitin 1968, në Han të Elezit ndodhë edhe një ngjarje me shumë rëndësi. Haxhi Ymeri, babai i Ramadan Ymerit (Furragjisë) me prejardhje nga Hasi, më 27.11.1968 e ngritë flamurin kombëtarë shqiptarë pa yllin pesëcepësh dhe e vendosë te Furra „Drini i Bardhë''.

[34] Informatë nga Halil Dernjani(1943) dhënë autorit në qershorin e vitit 2025

Po në vitin 1968, në Kaçanik, më saktë në holin e shkollës fillore „Emin Duraku" vendoset për herë të parë busti i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, vepër e cila përkonte me 500 vjetorin e vdekjes së Skënderbeut.
Më 11 shkurt 1969, Sali Bajra si kryetar i Kuvendit Komunal të Kaçanikut i dërgon Demarsh Republikës së Maqedonisë për dhunën që ushtronte policia maqedonase ndaj shqiptarëve që jetonin në këtë ish republikë jugosllave, si dhe malltretimet që u bënte, popullatës së trevës së Kaçanikut që udhëtonin për në Maqedoni. Përpos kësaj, në Han të Elezit ai vendosi edhe postbllokun policor, karshi kësaj republike ish Jugosllave. Gjitha këto veprime dhe shumë të tjera të Sali Bajrës, alarmuan politikën jugosllave titiste në Beograd dhe më 12 tetor 1969[35] e shkarkojnë nga posti i kryetarit të komunës së Kaçanikut.
Natyrisht që politika jugosllave dhe shërbët-torët e tyre, shkatërruan karrierën e Sali

[35] Latif Nallbani ,,Sali Bajra-opozitar i totalitarizmit'', Prishtinë 2007, faqe 68

Bajrës, duke sjellur atë dhe shokët e tij, në një gjendje të rëndë ekonomike, deri në kothere buke, por ai mbet i dashur dhe i pa harrueshëm për popullin shqiptarë dhe me pietet të rrallë e kujtojmë edhe sot. Fryma kombëtare e Sali Bajrës, depërtoi në çdo shtëpi. Sali Bajra u bë shembulli i një veprimtari të guximshëm dhe i një udhëheqësi i lidhur si mishi me thonin me popullin.

Sa herë që Sali Bajrës, tanimë i mbetur rrugëve i ngushtohej shpirti, dhe i mbylleshin të gjitha shtigjet e këto ishin të shpeshta, përballë shtronte gotën e Omer Kajamit dhe pa iu trembur syri nga udbashët që e rrethonin, Sali Bajra ia thoshte këngës së Martaneshit, këngë e cila në mënyrën më tipike ishte sinonim për Kaçanikun; për Kaçanikun e Idriz Seferit, për Kaçanikun në përballje me Dërgut Pashën, për Kaçanikun ku kali notuar kishte në gjak… Këtë këngë kushtrimtare jo vetëm që e këndonte Saliu, por ajo mori dhenë qytetit dhe katundeve gjithandej dhe ajo mbahej mend dhe këndohej edhe tek gjeneratat e asaj kohe:

Zjarr në male, zjarr në kodra
Po na vjen pasha me lodra.

Zjarr në male, zjarr në bjeshkë
Dojnë ta djegin, Martaneshin.

Sun e djegësh Martaneshin
Shtatë vjeç djali rrok dyfekin
Porsi gjarpni me nantë krenë.

Mahmut Pasha, rrem dragoi
Të nantë male qi kërkoi
Martaneshin sun e shtroi.

Martaneshi, vend i mirë,
S`duron pashë  e s`duron vezir!
Martaneshi, vend i mirë
S`duron krajl e s`duron vezir!



Sali Bajra (1934-2006)

Detaj nga varrimi i Sali Bajrës, 13 dhjetor 2006,Kaçanik

Me 23 shtator 1968, Komiteti Krahinor i Lidhjes së komunistëve mbajti plenumin e XVI dhe nxori disa konkluza:

Ndër të tjera u tha se gjendja politike në krahinë ishte pozitive, se do të zhvillojmë betejë të pamëshirshëm ndaj armikut klasorë, Lidhja e Komunistëve do të luftojë kundër të gjithë nacionalizmave dhe konkluza të tjera të këtij lloji, por askush nuk debatoi në thellësinë e problemeve, askush nuk debatoi për prapambetjen kaq të thellë ekonomike dhe të sferave të tjera të jetës shoqërore…

Megjithate, të pakënaqur me rrethanat e gjithmbarshme që mbretëronin në Kosovë, një delegacion i Krahinës së Kosovës, në krye me Fadil Hoxhën, Veli Devën, Ilaz Kurteshin e Ismail Bajrën, në fillim të nëntorit 1968 realizuan një takim me Titon në Beograd dhe ndër të tjera u diskutua se:

…Pozita e Krahinës është bukur e vështirë dhe se ajo nuk është në gjendje me i zgjidhë disa problem serioze që janë akumulu dhe kërkojnë zgjidhje ma efikase. Delegacioni njoftoi Titon se politikat e aprovueme për

stimulim të këtyre viseve nuk po realizohen dhe se treguesit e zhvillimit tregojnë se diznivelizimi në vend që të pakësohet ai po shtohet… edhe disproporcioni me tempon e zhvillimit të krahinës në krahasim me viset e tjera po shtohet… dhe se Kosova edhe në kuadrin e viseve të pazhvillueme ka ngelur mbrapa dhe se pasojat e një situate të tillë janë të mëdha…[36]

Në anën tjetër, brenda këtyre rrethanave shoqërore-politike, djalëria kosovare fshehurazi po përgatiste demonstratat e nëntorit 1968, të parat e këtij lloji me kërkesa kombëtare pas LDB-së.

Në fakt, në 500 vjetorin e vdekjes së Skënderbeut, në majin e vitit 1968 u mbajtë një Simpozium për këtë ngjarje, por derisa po mbahej Simpoziumi, në muret e disa objekteve në Prishtinë si në Institutin albanalogjik, në muret e fakultetit ekonomik-juridik dhe në objektet të tjera, nacionalizmi dhe shovenizmi serb u paraqit me parulla

[36] Burimi" Rilindja e datës 4 nëntor 1968

fyese ndaj shqiptarëve. Ndërsa në Gjilan dhe në disa fshatra me përkatësi serbe u gjetën parulla në mbrojtje të Rankoviqit.

Në vorbullën e këtyre ngjarjeve, Komisioni statutar i Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë, arsyeton kërkesën që emërtimi i tillë si ,,Metohi′′ të ndryshohet sepse nuk i përgjigjet as historisë as shtrirjes gjeografike e as fakteve shkencore… Në vija shumë fragmentare, kjo ishte gjendja e brendëshme, po si ishte ajo ndërkombëtare?

Në maj të vitit 1968 shpërthyen demonstratat e mëdha studentore në Francë duke u shoqëruar edhe me greva të mëdha punëtorësh duke marrë pjesë rreth 10 milionë njerzë.

Demonstrata të tilla kishte edhe në Gjermaninë Perëndimore, kundër autoritarizmit e madje edhe kundër luftës që po zhvillohej në Vietnam.

Në këmbë ishte dhe Italia, pastaj Çekosllovakia, Britania e Madhe. Në rrjedhë të frymës europiane, nuk munguan as demonstratat studentore në Beograd kundër kushteve ekonomike dhe mungesës së lirive

politike. Demonstrata masive kishte edhe në Amerikë, Kanada, Meksikë, Argjentinë, Brazil, Kili, Afrikë, Japoni e gjetiu. Pra viti 1968 ishte viti i kryengritjeve studentore për liri më të mëdha.

Ndërsa në Kosovë çdo tendencë për liri dhe të drejta qytetare e etnike, cilësoheshin armiqësore, nacionaliste e kundër revolucionare. Megjithate…

Djalëria kosovare, duke e shfrytëzuar frymën ndërkombëtare të këtyre demonstratave, gjeti forcë organizimi dhe me 27 nëntor 1968, shpërtheu me demonstrata masovike si në Prishtinë dhe qytete të tjera për flamur e universitet e për pasojë ato u shtypën nga aparati shtetëror, pjesëmarrësit u burgosën dhe u dënuan, ndërsa klasa politike autonomiste, demonstratat i quajti nacionaliste dhe reaksionare, ashtu siç do t`i quan edhe demonstratat e vitit 1981 për Republikë.

Në fakt, demonstratat u shndërruan në një levë që nxori nga toka atë gurin shtypës që kishte dekada që po e rëndonte shpinën dhe qafën e shqiptarit. Demonstratat shpërthyen

moçalin evolucionist të autonomistëve. Demonstratat e vitit 1968 krijuan edhe njeriun e ri, ngjallën shpirtin krijues, mobilizues e kryengritës për një jetë më të mirë, për një çlirim nacional e social. Demonstratat e vitit 1968 u shndërruan në një lokomotivë që i tërhiqte përpara të gjitha proceset. Lokomotiva e këtyre demonstratave synonte t`u jepte shpirt edhe vetë klasës politike autonomiste,por…
Pas demonstratave të vitit 1968 dhe realizimit të disa kërkesave të rëndësishme politike si të flamurit e Universitetit e më pas edhe të Kushtetutës së vitit 1974, jeta në Kosovë mori një kahje më të mirë dhe më zhvillimore, por megjithate larg synimeve tona kombëtare.

***

Duke iu rikthyer temës që po trajtojmë, në vitin 1968, për nevojat e banorëve të trevës së Hanit të Elezit, punonin disa dyqane zejtare, dy furra buke, dy rrojtore, dy shitore të koperativës, tri kafene, një kupucëtar, farkatar dhe teneqexhi.[37] Po në vitin 1968 filloi puna

[37] Përparimi nr.11-12, 1968

për rikonstruktimin e fabrikës, më sakt filloi puna për ndërtimin e furrës së re automatike. Me furrën e re automatike, parashiheshin 300 mijë tonelata çimento në vit, prodhimtaria do të ishte më cilësore dhe do të rriteshin edhe kapacitetet prodhuese. Pajimet e kësaj furre i mori mbi vedi në formë huaje, ndërmarrja Litostroj e Lublanës. Ngritja e kësaj furre automatike që planifikohej të futej në prodhim në qershorin e vitit 1969, do të rriste edhe numri i punëtorëve. Viti 1974 shënon edhe të arritura të tjera në kuadër të kësaj fabrike, ndërsa në aspektin e përgjithshëm, që nga 21 shkurti 1974 kur u miratua Kushtetuta e RSFJ-së e rrjedhimisht edhe Kushtetuta e Krahinës socialiste autonome të Kosovës (KSAK) më 28 shkurt 1974, kemi një nivel tjetër zhvillimi. Forcat progresiste autonomiste edhe brenda vetë sistemit përpiqeshin të gjenin hapësira veprimi, por darat unitariste serbo-maqedono-malazeze ishin tepër të fuqishme. Ato nuk mund t`i shkatërronte evolucioni. Pas vdekjes së Titos në vitin 1980, këto forca unitariste po shtrëngonin edhe më shumë, dukshëm e pa-

dukshëm, qenien shqiptare. Kjo u vërejt qartazi kur vdiq Rankoviqi.Populli serb i bëri një varrim madhështorë që don të thoshte se fryma rankoviqiste serbe në politikë ishte e gjallë dhe e fuqishme.

Pas Kushtetutës së vitit 1974, kjo trevë edhe zyrtarisht filloi të quhet ashtu siç duhej, Hani Elezit, ndërsa në gjuhën serbe, zyrtarisht mbeti sërish ai emri i urryer Gj. Jankoviq. Më 3 prill 1975, nga një vizitë e Titos në Kosovë, ai e vizitoi edhe Hanin e Elezit. Titoja erdhi nga Shkupi me trenin e kaltër dhe pritjen ia bënë Mahmut Bakalli e Xhavit Nimani kuadro të larta të Krahinës së Kosovës. Pas qëndrimit disa minutësh, me eskordën e tij me makina udhëtuan për në Prishtinë. E mbajmë mend këtë ngjarje sepse, paraprakisht u shtrua për herë të parë rruga me asfalt nga qendra deri te stacioni hekurudhor. Pastaj mbi asfalt u shtrua një tepik i kuq, ndërsa për disa ditë me radhë u pastrua Hani i Elezit nga mbeturinat e çka jo tjetër.

Në vitin 1975 ngritet edhe fabrika e azbestçimentos, por pas luftës së Kosovës së vitit

1999, kjo fabrikë doli të jetë kancerogjene dhe ka lënë pasoja të rënda si tek punëtorët e gjithashtu edhe në kontaminimin e tokës dhe ambientit me pasoja afatëgjata. Ngritet edhe fabrika e stiroporit si filialë e INA-OKI-it të Kroacisë.



Detaj nga fabrika e çimentos, 1975[38]

[38] Burimi: Rilindja



Me këto asete ekonomike Hani i Elezit u shndërrua në një vend industrial, por burokracia ekonomike me ndikimin e komitetlinjëve, asnjëherë nuk lejoi që kjo fabrikë të ketë një drejtor nga treva ku pluhuri po çimentoste organet e frymëmarrjes. Këtyre viteve, krijohen edhe kuadrot e reja vendore arsimore dhe shkolla si institucion edukativo-arsimor filloi të merr fizionominë e saj. Nëpërmjet Shoqërisë Kulturore Artistike „Sharri" dhe Klubit të Futbollit „Sharri' si zhvillime të mëvonshe (1974) filloi edhe zhvillimi i jetës kulturore, me një fjalë mori krah emancipimi

publik shoqëror. Në kuadër të Shoqërisë Kulturore e Artistike „Sharri" për herë të parë po jepnin kontributin e tyre edhe gjinia femërore. Me pjesëmarrjen e saj në aktivitete kulturore po shkatërrohej tabuja dhe stigmatizimi i femrës.

Rikthimi i statusit të komunës

Me rithemelimin e komunës më 22 shtator të vitit 2005, në kushte dhe rrethana krejtësisht të reja dhe në liri, Hani i Elezit pësoi një transformim rrënjësorë. U bë zgjidhja infrastrukturore e të gjitha rrugëve, urbane e rurale, kanalizimeve, shkollave, fushave sportive, QKMF-së, ndriçimit publik, objekteve kulturore dhe gjitha gjërave të tjerave të nevojshme për një jetë normale. Gjitha këto ndryshime ndodhën si produkt i lirisë dhe çlirimit të Kosovës nga pushtuesi serb, falë luftës së lavdishme të UÇK-së, rezistencës popullore dhe ndihmës së faktorit ndërkombëtarë NATO-s.

Aktualisht kjo komunë ka 8 mijë e 600 banorë.

Momente gjatë themelimit të komunës së Hanit të Elezit, 22 shtator 2005, ku këshilltarët e Asamblesë komunale të Hanit të Elezit japin betimin

Përmbyllje

Libri: ***Treva e Hanit të Elezit 1945-1975*** paraqet periudhën tridhjetë vjeçare të historikut dhe të zhvillimit të sajë. Fillimisht e shkrova në formë të një punimi seminarik, por në rrjedhë të hulumtimit dhe duke pasur parasysh se gjenaratat e reja shumë pak dinë për këtë periudhë, vendosa ta shndërroj në formë libri.

Kjo periudhë, deri më tani ishte faza më pak e ndriçuar. Gjeneratat e vjetra, si protagonist të kohës, gjithnjë e më shumë po shuhen dhe po mungon subjekti njeri si dëshmues kohe. Duke i pasur parasysh këto, një hulumtim i tillë na doli i domosdoshëm.

Tanimë kemi një pasqyrë më të detajuar të kësaj periudhe e cila natyrisht që ishte e rëndë sepse të rënda ishin edhe vetë rrethanat. Aparati fotografik si dëshmues kohe ishte në duar të rralla; tek ndonjë nënpunës fabrike, te ndonjë mësues shkolle apo te ndonjë gazetar i Rilindjes që vinte nga Prishtina në raste më specifike. Në rrjedhë të kohës, kjo trevë është

mbuluar me kronika edhe nga gazetari i Kaçanikut dhe herë pas here edhe të mësuesve të shkollave me kronika arsimore. Të gjitha këto burime, ne i shfrytëzuam në shkallë të gjerë, shfrytëzuam burimet e gazetës ,,Rilindja'' si kronika faktike të ngjarjeve dhe pos Arkivit, kemi shfrytëzuar edhe Platformën e gazetave dhe librave digjitale në books.flossk.org

Në materien e trajtuar, krahas të tjerave, kemi fokusuar edhe veprimtarinë e fabrikës së çimentos në Han të Elezit. Kjo fabrikë ishte një ndër faktorët më domethënës sepse banorët e kësaj ane ishin të lidhur fortë me atë, fabrika ishte burim i të ardhurave materiale e në anën tjetër ishte edhe mbështetësi kryesor i komunitetit. Nëpërmjet kësaj fabrike u formua edhe Shkolla Ekonomike ku arritën të dalin edhe kuadrot e para për nevojat e fabrikës, pra kishte edhe rolin arsimor dhe profesional. Për aq sa i kishte mundësitë, kjo fabrikë ndau bursa në vazhdimësi për nxënës edhe pse vetë fabrika kishte hallet e veta prodhuese.

Tanimë lexuesi ka në duarë, pavarësisht vëllimit të sajë, një libër apo një libërth me të dhëna faktike dhe sot dimë më shumë se dje. Libri në fjalë luan rolin e një ,,ndërlidhësi'' ndërmjet kohës së shkuar, të tashmes dhe të kohës së ardhme. Të njohësh të kaluarën donë të thotë të vlerësosh të tanishmen dhe të hapërosh për të ardhmen.
Në fakt, ky ishte edhe qëllimi.

Autori: Shaban Çupi
qershor, 2025

Burimet dhe literatura

Monografia „Sharri'' 1936-1986, Maribor, 1986
Gazeta informative „Sharri'' nr.63, nëntor 1986
Karakteristikat themelore të zhvillimit ekonomiko-shoqëror të komunës së Kaçanikut, Kaçanik 1979
Emrush Dernjani „Hani i Elezit me rrethinë, Prishtinë, 2001
Shaban Çupi„Gjurmime etnografike në trevën e Hanit të Elezit'' Ferizaj, 2016
Shaban Çupi„Jatakët e lirisë'' Ferizaj, 2012
Shaban Çupi „Panoramë e trashëgimisë kulturore dhe historike në trevën e Hanit të Elezit'', 2025
Engjëll Gjini „Fshatrat e rrethinës së Elez Hanit'' Përparimi 1968
Engjëll Gjini „ Përparimi'' 1970, Prishtinë
Gazeta „Rilindja'' Prishtinë
Platforma digjitale e librave dhe gazetave books.flossk.org
Arkivi i Kosovës dhe i Kaçanikut
Historiku i SHFMU „Ilaz Thaçi'' Hani i Elezit
Historiku i SHFMU„Kështjella e Diturisë'' Paldenicë

Burimet njerëzore:
Halim Ballazhi, Shaban Mezraja, Emërllah Thaçi, Sinan Laçi, Sefer Dernjani, Mexhait Berisha, Fehmi Shkreta, Shefket Lusnjani, Hekrem Brava, Halil Dernjani

Shaban Çupi është i lindur më 2.1.1961 në fshatin Paldenicë të Hanit të Elezit. Ka të kryer Fakultetin e Edukimit dhe në arsim punon nga shtatori i vitit 1980. Është dy herë ish i burgosur politik, njëherit edhe përjetues i masakrës serbe ndaj të burgosurve shqiptarë në majin e vitit 1999 në Dubravë të Istogut. Krijimtaria e tij hulumtuese është kryesisht nga trashëgimia jonë kulturore e historike.

Deri më tani ka botuar këto libra:
1.*Nga gjaku i tyre rrjedh liria*, poemë
2.*Gafurr Loku (1949-1999)* monografi
3.*Shënime në kohë të mugëllt-publicistikë*
4.*SHKA ,,Sharri'' në 40 vjetorin e aktivitetit'' në Han të Elezit*-monografi

5.*Jatakët e lirisë*- monografi
6.*Gjurmime etnografike në trevën e Hanit të Elezit*
7.*Shkolla popullore shqiptare në fshatin Paldenicë,* me bashkautor
8.*Trashëgimia kulturore në trevën e Hanit të Elezit* me bashkautor
9.*Historiku i xhamive dhe shkrimet mbivarrore në trevën e Hanit të Elezit*
10. *Gafurr Loku në kthetrat e UDB-së*
11.*Veprimtaria poetike e grupit letrar ,,Luigj Gurakuqi'' (1991-1993) në Han të Elezit*
12.Buzëqeshje lirie, poemë kushtuar dëshmorit Gafur Luma
13. *Gafurr Luma*, jeta dhe vepra, monografi
14.*Gafurr Loku simbol lirie e bashkimi,* monografi
15.Nositët e lirisë, poemë kushtuar dëshmorë-ve të komunës së Hanit të Elezit
16. *Rrëfimet e Elez Hanxhiut*, tregime
17.*Flakadanët e lirisë 2* Monografi për Dëshmorët e Hanit të Elezit, botim elektronik në Internet archive
18. *Gjurmme antroponimike* në trevën e Hanit të Elezit

19.*Të burgosurit politik 1946-1999 në komunën e Hanit të Elezit,* monografi
20. *Panoramë e trashëgimisë kulturore e historike në trevën e Hanit të Elezit*
21. Nositët e lirisë 2, poemë për dëshmorët, botim elektronik në Internet archive
22. Treva e Hanit të Elezit 1945-1975, botim elektronik në Internet archive

Barkodi ku librat e autorit Shaban Çupi janë të botuara në mënyrë elektronike në Internet archive